

## Përmbledhje

- **Gjatë TM3 2025, ekonomia e eurozonës shënoi rritje vjetore prej 1.4 përqind, mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve, ndërsa bilanci tregtar ndikoi negativisht. Inflacioni mbeti pranë objektivit të BQE-së, rreth 2.1 përqind, me kontribut kryesor nga shërbimet dhe ndikim negativ nga energjia.** Normat e interesit mbetën të pandryshuara dhe BQE parashikon rritje ekonomike prej 1.2 përqind për vitin 2025. **Në Ballkanin Perëndimor, rritja ekonomike mesatare arriti në 3.1 përqind, që pasqyron qëndrueshmërinë e rajonit përballë sfidave strukturore.** Megjithatë, tensionet gjeopolitike, barrierat tregtare dhe ekspozimi ndaj luhatjeve në ekonominë e eurozonës, së bashku me faktorët e brendshëm përfshirë pasigurinë politike, vazhdojnë të përbëjnë rreziqe për perspektivën e rritjes ekonomike.
- **Ekonomia e Kosovës në TM3 2025 shënoi rritje të moderuar prej 3.1 përqind, duke reflektuar rritje më të ngadalësuar krahasuar periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Rritja u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, veçanërisht nga konsumi privat dhe investimet, ndërsa konsumi publik kontribuoi negativisht. Eksporti i mallrave vijoi trendin rënës, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi rritje të lehtë. Në të njëjtën kohë, importi i mallrave u rrit ndjeshëm, duke ndikuar në bilancin tregtar. Në aspektin sektorial, ndërtimtaria dhe industria dhanë kontributin kryesor në rritjen ekonomike, ndërsa sektori i energjisë kontribuoi negativisht. Përkundër ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, u shënuar rritje e konsiderueshme e regjistrimit të ndërmarrjeve të reja. Për gjithë vitin 2025, BQK parashikon rritje ekonomike prej 3.9 përqind, e mbështetur nga konsumi, investimet dhe eksporti i shërbimeve, ndërsa importi pritet të ketë ndikim negativ.
- **Inflacioni u përshpejtua në 4.5 përqind në TM3 2025, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimit, energjisë dhe shërbimeve, ndërsa çmimet e mallrave tjera mbetën pothuajse të pandryshuara.** Ecuri rritëse u evidentua edhe në inflacionin bazë, i cili rezultoi 2.1 përqind, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të shërbimeve. Sa i përket origjinës, inflacioni pasqyroj presione të kombinuara nga ndikimi i faktorëve të jashtëm përmes importit dhe ekonomisë së brendshme përmes shërbimeve.
- **Sektori fiskal gjatë TM3 2025 shënoi rritje si në të hyra ashtu edhe në shpenzime buxhetore.** Të hyrat primare buxhetore arritën vlerën neto prej 892.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.8 përqind. Shpenzimet buxhetore po ashtu shënuan rritje prej 7.3 përqind, duke arritur në 809.7 milionë euro. Si rezultat, suficiti primar buxhetor arriti vlerën prej 115.7 milionë euro.
- **Llogaria rrjedhëse në TM3 2025 rezultoi me bilanc pozitiv prej 230.7 milionë euro, megjithëse shënoi rënie vjetore prej 6.7 përqind, kryesisht si rezultat i thellimit të deficitit tregtar të mallrave.** Performanca e qëndrueshme e bilancit të shërbimeve, së bashku me kontributin pozitiv të të ardhurave parësore dhe dytësore, arriti të kompensojë presionin negativ nga tregtia e mallrave. Remitencat në këtë tremujor arritën në 393.7 milionë euro, duke shënuar rritje prej 3.4 përqind, ndërsa investimet e huaja direkte shënuan rritje prej 20.6 përqind, duke arritur vlerën prej 298.7 milionë euro.
- **Sektori bankar ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar të aseteve, duke arritur në 9.14 miliardë euro, kryesisht si rezultat i zgjerimit të kreditimit.** Megjithatë, në krahasim tremujor, ritmi i rritjes së kreditimit u ngadalësua dhe stabilizua për tremujorin e dytë radhazi, si pasojë e rënies së kredive të reja investuese për korporatat jofinanciare dhe gjithsej kredive të reja për ekonomitë familjare. Ndërsa, depozitat u karakterizuan me rritje të përshpejtuar, ndikuar kryesisht nga zgjerimi i depozitave të ekonomive familjare. Norma mesatare e interesit në kredi dhe depozita ka shënuar rritje, duke arritur në 6.9 përqind dhe 3.1 përqind, respektivisht, në fund të shtatorit 2025. Portfolio kreditore vazhdon të ketë cilësi të mirë, me rritje marginale të nivelit të kredive joperformuese nga tremujori paraprak, ndërsa nga viti i kaluar ky nivel ka mbetur i njëjtë. Profiti i sektorit bankar ka shënuar rënie, si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të të hyrave në raport me rritjen e shpenzimeve. Nga ana tjetër, treguesit kyç të stabilitetit të sektorit, përfshirë pozicionin e kapitalit si dhe treguesit e likuiditetit dhe të financimit, u përforcuan më tej.
- **Sektori pensional shënoi rritje të mëtejshme të vlerës së aseteve, të mbështetura nga rritja e kontributeve të arkëtuara dhe kthimet pozitive nga investimet.** Investimet mbetën të përqendruara në tregjet e jashtme, me ekspozim të lartë në fondet e përbashkëta. Si rezultat, çmimi i njësisë së aksioneve shënoi rritje, duke pasqyruar performancën e portfolit pensional.
- **Sektori i sigurimeve shënoi ngadalësim në rritjen e aseteve dhe primeve të shkruara, veçanërisht në segmentin jo-jetë.** Dëmet e paguara u rritën, ndërkohë që edhe fitimi neto shënoi rritje, i mbështetur nga rritja e të hyrave dhe menaxhimi i qëndrueshëm i shpenzimeve. Treguesit e qëndrueshmërisë dhe likuiditetit mbetën në nivele të shëndosha.
- **Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar vazhdoi rritjen dyshifrore, por me ritëm më të ngadalësuar.** Financimi i aktivitetit mbështetet kryesisht nga huamarrjet në sektorin e jashtëm, të cilat shënuan trend të ngadalësuar të rritjes. Kreditimi u zgjerua si për ekonomitë familjare, ashtu edhe për korporatat jofinanciare, ndërsa lizingu shënoi rënie, veçanërisht në segmentin e korporatave jofinanciare. Fitimi neto shënoi ngadalësim si pasojë e rritjes më të shpejtë të shpenzimeve, ndërkohë që kreditë joperformuese mbetën të ulëta dhe të mbuluara mirë me provizione.

## Lista e shkurtesave

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FAO	Food and Agriculture Organization (Organizata për Ushqim dhe Bujqësi)
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KJF	Korporatat jo-financiare
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
MMBTU	Metric Million British Thermal Unit
WEO	World Economic Outlook

## Përmbajtja

Përmbledhje .....	i
1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor .....	3
2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare .....	4
3. Ekonomia e Kosovës .....	5
3.1. Rritja Ekonomike .....	6
3.2. Çmimet .....	7
3.3. Sektori Fiskal .....	8
3.4. Sektori i jashtëm .....	9
4. Sistemi financiar .....	11
4.1. Sektori bankar .....	12
4.2. Sektori pensional .....	19
4.3. Sektori i sigurimeve .....	20
4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar .....	22

## 1. Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

**Gjatë TM3 2025, ekonomia e eurozonës shënoi rritje tremujore prej 0.3 përqind dhe rritje vjetore prej 1.4 përqind. Kontribues kryesor i kësaj rritjeje ishte formimi bruto i kapitalit, me +0.2 pikë përqindje.**

Duke qenë se investimet kishin pasur kontribut negativ në tremujorin paraprak, rritja e tyre përbën zhvillimin më të rëndësishëm pozitiv në dinamikën ekonomike të eurozonës. Kategoritë tjera të kërkesës agregate, si konsumi privat, konsumi publik dhe ndryshimet në inventarë, kontribuan secila me +0.1 pikë përqindje në rritjen ekonomike. Bilanci tregtar ndikoi negativisht në rritjen ekonomike, me -0.2 pikë përqindje. Rritja e investimeve ka ndikuar në rritje të vlerës së importit, veçanërisht nga SHBA-të dhe vendet e Azisë, ndërkohë që rritja më e ngadalësuar ekonomike e partnerëve kryesorë tregtarë kufizoi kërkesën për eksportet e eurozonës. Si pasojë, importet tejkaluan eksportet dhe bilanci tregtar pati kontribut negativ në rritjen ekonomike. Në mesin e ekonomive më të mëdha të bllokut, Spanja dhe Franca patën rritje ekonomike prej 0.6 përkatësisht 0.5 përqind, ndërsa Gjermania dhe Italia nuk patën ndryshim. Për gjithë vitin 2025, BQE ka paraparë rritje ekonomike prej 1.2 përqind, duke shënuar përmirësim nga parashikimi prej 0.9 përqind të publikuar në muajin mars.


**Inflacioni në eurozonë në TM3 2025 arriti në 2.1 përqind, ndërsa në muajin shtator u regjistrua rritje prej 2.2 përqind, duke mbetur në linjë me objektivat e BQE prej 2 përqind.** Kontribuesit kryesorë të inflacionit ishin shërbimet, me +1.49 pikë përqindje, të përcjella nga ushqimi, alkooli dhe duhani me +0.58 pikë përqindje dhe mallrat industriale me +0.2 pikë përqindje. Energjia pati kontribut negativ në inflacion, me -0.03 pikë përqindje, duke reflektuar stabilizimin e çmimeve të energjisë dhe zbehjen e efektit bazë. Megjithëse çmimet e gazit dhe naftës mund të shfaqin luhatje mujore, nuk vërehet presion i vazhdueshëm në rritjen e tyre. Normat kryesore të interesit në eurozonë mbetën të pandryshuara krahasuar me TM2 2025. Norma e depozitave u ruajt në 2.0 përqind, norma e rifinancimit në 2.15 përqind dhe norma e kreditimit në 2.4 përqind, duke reflektuar qëndrimin e kujdesshëm të politikës monetare të BQE-së në funksion të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve.

**Ekonomitë e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje mesatare prej 3.1 përqind në TM3 2025** (grafik 1). Maqedonia e Veriut shënoi rritje vjetore prej 3.8 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së ndjeshme të investimeve, veçanërisht në ndërtimtari dhe infrastrukturë. Po ashtu, Shqipëria regjistroi rritje prej 3.8 përqind, e mbështetur kryesisht nga eksporti dhe konsumi publik. Në Mal të Zi, aktiviteti ekonomik u rrit me 3.1 përqind, nxitur nga kërkesa e brendshme dhe rritja e pagave reale, ndërsa Serbia shënoi rritje më të ulët në rajon, prej 2.0 përqind, si pasojë e rënies së investimeve dhe rritjes së deficitit tregtar. Në përgjithësi, ky ritëm i rritjes tregon

qëndrueshmërinë e rajonit përballë sfidave strukturore dhe rreziqeve të jashtme. Megjithatë, tensionet gjeopolitike, barrierat tregtare dhe ekspozimi ndaj luhatjeve në ekonominë e eurozonës e bëjnë rajonin të ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme. Pasiguritë që burojnë nga politikat tregtare globale, të kombinuara me faktorët e brendshëm, përfshirë pasigurinë politike, vazhdojnë të përbëjnë rreziqe shtesë për perspektivën afatmesme të rritjes ekonomike. Edhe projeksionet e FMN-së, të publikuara në tetor 2025, sugjerojnë se rajoni i Ballkanit Perëndimor pritet të shënojë rritje mesatare ekonomike prej 3.1 përqind në vitin 2025 dhe 3.4 përqind në vitin 2026. **Inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor u përshpejtua nga 3.7 përqind në TM2 2025 në 4.1 përqind në TM3 2025, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të ushqimeve dhe shërbimeve, në një mjedis ku presioni nga rritja e pagave mbeti i pranishëm.** Shkalla më e lartë e inflacionit u shënuar në Mal të Zi, prej 4.7 përqind, ndërsa Shqipëria shënoi normën më të ulët, prej 2.4 përqind.

Në TM3 2025, kursi i këmbimit i euros shfaqti luhatje të ndryshme ndaj valutave të partnerëve tregtar. Euro u vlerësua ndaj lirës turke, dollarit amerikan dhe sterlinës britaneze krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa u zhvlerësua ndaj lekut shqiptar dhe frangut zviceran. Kursi i euros mbeti pothuajse i pandryshuar ndaj denarit maqedonas.

Grafik 1. Rritja ekonomike dhe inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor (TM3 2025)




Burimi: Agjencitë statistikore përkatëse.

## 2. Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare shënuan luhatje të lehta gjatë TM3 2025. Indeksi i Bankës Botërore regjistroi rënie vjetore prej 7.1 përqind, ndikuar kryesisht nga rënia vjetore e çmimeve të energjisë dhe e disa kategorive të ushqimit. Ndërsa, në terma tremujorë, u evidentuan presione të lehta inflacioniste, të nxitura kryesisht nga luhatjet e çmimeve të energjisë dhe rritja e çmimeve të metaleve dhe mineraleve. Si rrjedhojë, projeksioni i Bankës Botërore për rënien e çmimeve të mallrave bazë në vitin 2025 u rishikua nga -12.4 përqind në prill në -7.4 përqind në tetor. Për vitin 2026, Banka Botërore parashikon një rënie të mëtejme të çmimeve prej 6.8 përqind. Megjithatë, perspektiva mbetet e shoqëruar me pasiguri të larta, të lidhura me zhvillimet gjeopolitike, politikat e tregtisë globale dhe ecurinë e aktivitetit ekonomik global.

**Çmimi i naftës së papërpunuar Brent rezultoi mesatarisht \$69.0/fuçi gjatë TM3 2025, duke shënuar një rënie vjetore prej 13.9 përqind (Grafiku 2).** Në terma tremujorë, u regjistrua një rritje e lehtë prej 1.8 përqind, e nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve në muajin qershor dhe rënia më e ngadalshme e tyre, si pasojë e reduktimit të eksporteve nga Lindja e Mesme dhe pasigurive rreth ofertës globale. Megjithatë, rritja më e shpejtë se sa pritej e prodhimit nga OPEC+ dhe niveli i lartë i rezervave në SHBA, neutralizuan deri në një masë presionet inflacioniste. Në periudhën në vijim, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik global dhe rritja e prodhimit nga OPEC+ pritet të ushtrojë presione në kahun rënës mbi çmimet e naftës. Megjithatë, ecuria e tyre mbetet e ekspozuar ndaj rreziqeve potenciale, veçanërisht nga tensionet gjeopolitike dhe tregtare dhe implikimet në ofertë.


Grafik 2. Çmimet e naftës dhe gazit natyror në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Banka Botërore.

**Çmimet e gazit natyror në Evropë ranë në mesatare prej \$11.3/mmbtu gjatë TM3 2025, duke shënuar një rënie vjetore prej 1.8 përqind dhe rënie prej 4.9 përqind në terma tremujorë.** Kjo rënie u diktua nga kërkesa më e ulët nga sektori energjetik dhe rritja e eksporteve të gazit natyror të lëngshëm (LNG) drejt Evropës. Këto zhvillime u nxitën pjesërisht nga përshkallëzimi i tensioneve tregtare mes Azisë dhe Shteteve të Bashkuara, përfshirë vendosjen e tarifave, që çuan në ridrejtimin e eksporteve të LNG-së drejt tregut evropian. Deri në nëntor, çmimet e gazit natyror vlerësohet të jenë rritur për 13.9 përqind, mbi parashikimin prej 10.4 përqind të Bankës Botërore për vitin 2025, ndërsa për vitin 2026 parashikohet një rënie prej 10.7 përqind.

Grafik 3. Indeksi i metaleve dhe mineraleve dhe metaleve të çmuara



Burimi: Banka Botërore.


**Indeksi i çmimeve të metaleve dhe mineraleve në TM3 2025 shënoi rritje vjetore prej 5.6 përqind dhe 4.4 përqind në terma tremujorë (grafiku 3), duke pasqyruar aktivitetin relativisht të qëndrueshëm ekonomik në ekonomitë e mëdha.** Rritja u mbështet kryesisht nga kërkesa për alumin, bakër dhe kallaj, e nxitur nga investimet në zgjerimin e infrastrukturës së energjisë së ripërtëritshme dhe projektet e tjera të tranzicionit energjetik. Rritja e çmimit të xehes së hekurit pasqyroi rritjen e prodhimit të çelikut në Kinë, megjithëse kërkesa e ulët nga sektori i ndërtimit atje vazhdon të ushtrojë presion në kahun rënës për këtë kategori. Ndërsa, çmimet e nikelit vijuan të bien në sajë të rritjes së ofertës globale. Sipas Bankës Botërore, çmimet e metaleve dhe mineraleve vlerësohet të kenë shënuar rritje prej 3.9 përqind deri në nëntor dhe pritet të mbeten kryesisht të pandryshuara në vitin 2026. Rreziqet në kahun e poshtëm ndërlidhen me ecurinë e aktivitetit ekonomik global, posaçërisht në Kinë, ndërsa pengesat potenciale në ofertë dhe rritja potenciale e kërkesës nga sektori elektronik mund të ushtrojë presione inflacioniste.

**Indeksi i çmimeve të metaleve të çmuara në TM3 2025 shënoi rritje vjetore prej 38.8 përqind (grafiku 3), i diktuar nga çmimet rekorde të arit, me rritje vjetore prej 39.5 përqind, argjendit prej 34.2 përqind dhe platinit 44.2 përqind.** Në terma tremujorë, ky indeks shënoi rritje prej 6.9 përqind, nxitur nga investimet në ari dhe argjend si asete të sigurta dhe blerja e arit nga bankat qendrore, në një mjedis të karakterizuar nga tensione gjeopolitike dhe pasiguri globale. Rritja e çmimeve të argjendit i atribuohet edhe rritjes së kërkesës nga projektet e tranzicionit energjetik, ndërsa çmimet e platinit shënuan rritje të lartë si pasojë e kufizimeve

në ofertën globale. Çmimet e metaleve të çmuara vlerësohet të kenë shënuar rritje prej 41.0 përqind deri në nëntor, ndërsa për vitin 2026 parashikohet rritje më e ngadalësuar.

**Indeksi i çmimeve të ushqimit, sipas FAOs, në TM3 2025 rezultoi me rritje vjetore prej 5.8 përqind, diktuar nga çmimet më të larta të vajrave, bulmetit, dhe mishit krahasuar me TM3 2024** (grafiku 4). Kundrejt tremujorit paraprak, indeksi shënoi rritje prej 1.3 përqind, i ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të vajrave prej 8.1 përqind dhe mishit prej 3.3 përqind. Këto zhvillime u nxitën nga kërkesa e lartë për import të mishit, e cila tejkaloi ofertën në tregjet ndërkombëtare, si dhe nga rritja e kërkesës për vajra ushqimore nga sektori i biokarburanteve. Në anën tjetër, çmimet e drithërave dhe sheqerit shënuan rënie në terma tremujorë, kryesisht për shkak të ofertës së qëndrueshme dhe perspektivës së favorshme të prodhimit global. Ngjashëm, rënie më e lehtë u shënuar në çmimet e bulmetit që mbetën kryesisht të pandryshuara gjatë tremujorit, si rezultat i zbehjes së kërkesës në disa tregje kryesore importuese, si Azia, dhe rritjes së ofertës.

Grafik 4. Indeksi i çmimeve të ushqimit




Burimi: FAO.

### 3. Ekonomia e Kosovës

#### 3.1. Rritja Ekonomike

Gjatë TM3 2025, ekonomia e Kosovës shënoi ngadalësim të rritjes krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Sipas të dhënave të ASK-së, rritja reale e BPV-së arriti në 3.1 përqind, nga 3.8 përqind në TM3 2024 (Grafiku 5). Ky zhvillim reflekton moderimin e ritmeve të aktivitetit ekonomik, në një mjedis të karakterizuar nga presione inflacioniste më të larta. Rritja ekonomike gjatë kësaj periudhe u mbështet kryesisht nga kërkesa e brendshme, ndonëse me ritme më të moderuara. Kontributi më i lartë në rritjen e BPV-së ishte nga investimet, me +2.8 pikë përqindje. Krahasuar me gjysmën e parë të vitit, hendeku tregtar u ngushtua, për shkak të rënies së importit të shërbimeve dhe rritjes më të ngadalësuar të importit të mallrave. Ndërkohë, eksporti i mallrave ka vazhduar trendin rënës, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi rritje të lehtë.

Grafik 5. BPV-ja sipas shpenzimeve, 2022-25 (në pikë përqindje)




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Konsumi privat vijoi të kontribuojë pozitivisht në rritjen ekonomike, megjithëse me një ritëm më të ngadalësuar. Në TM3 2025, konsumi privat shënoi rritje prej 4.2 përqind, krahasuar me 4.4 përqind në TM3 2024. Ky ngadalësim lidhet kryesisht me rënien e kredive konsumuese dhe me rritjen e inflacionit, i cili arriti në 4.5 përqind gjatë kësaj periudhe, duke ndikuar negativisht në fuqinë blerëse të konsumatorëve. Megjithatë, konsumi privat u mbështet nga rritja e remitencave dhe kompensimit të punëtorëve. Në të kundërt, konsumi publik shënoi rënie prej 1.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.0 përqind në TM3 2024, duke ndikuar negativisht në konsumin e përgjithshëm.

Eksporti i mallrave shënoi rënie vjetore për 6.8 përqind, krahasuar me rritjen prej 7.1 përqind në TM3 2024. Kjo rënie u ndikua kryesisht nga performanca më e dobët e metaleve bazë dhe produkteve minerale, përfshirë energjinë elektrike, duke reflektuar si kufizimet në prodhimin vendor ashtu edhe kërkesën më të dobët të jashtme. Ndërkohë, eksporti i shërbimeve shënoi rritje prej 4.0 përqind, rritje kjo më e ulët krahasuar me rritjen prej 8.1 përqind në TM3 2024.

Grafiku 6. BPV-ja sipas aktiviteteve kryesore, 2022-25 (në pikë përqindje)




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Në anën tjetër, importi i mallrave shënoi rritje të lartë prej 11.9 përqind, gati dyfish më shumë se rritja prej 6.8 përqind në TM3 2024. Kjo rritje reflekton rritjen e kërkesës së brendshme, ndonëse me ngadalësim krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2025. Importi i shërbimeve shënoi rënie prej 5.1 përqind, krahasuar me rritjen prej 12.4 përqind në TM3 2024. Ndonëse shërbimet e transportit dhe udhëtimit kanë vijuar me rritje të qëndrueshme, shërbimet e tjera kanë ndikuar në uljen e rritjes reale të këtij komponenti.

Aktiviteti ekonomik gjatë TM3 2025 është mbështetur kryesisht nga ndërtimtaria dhe industria, të cilat dhanë kontribut më të lartë në rritjen e BPV-së. Ky zhvillim pasqyron rritjen e ndjeshme vjetore të ndërtimtarisë dhe zgjerimin e aktivitetit në industrinë përpunuese, tregti dhe shërbimet financiare e të sigurimit, të nxitura nga kërkesa e lartë vendore. Po ashtu, bujqësia kontribuoi pozitivisht në rritjen ekonomike. Në anën tjetër, sektori i furnizimit me energji elektrike vazhdoi të ketë ndikim negativ në aktivitetin ekonomik, si pasojë e rënies së prodhimit (grafiku 7).

Grafik 7. Numri i ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK.

Përkundër ngadalësimit të aktivitetit ekonomik, regjistrimi i ndërmarrjeve shënoi rritje të konsiderueshme. Në TM3 2025 janë regjistruar 3,437 ndërmarrje të reja, apo 16.4 përqind më shumë se në TM3 2024. Sektorët me

ndikim më të madh në këtë periudhë ishin tregtia, prodhimi, hoteleria dhe aktivitetet profesionale. Ndërkohë, janë shuar 278 ndërmarrje, apo 27.9 përqind më pak se gjatë periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Në përgjithësi, TM3 2025 u karakterizua nga rritje ekonomike e moderuar, e udhëhequr nga konsumi privat dhe investimet, krahasuar me tremujorin paraprak ku roli i sektorit publik ishte më i theksuar. Megjithatë, rënia e eksportit të mallrave dhe rritja e importit mbeten sfida strukturore për përmirësimin e bilancit tregtar dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike. Për vitin 2025, projeksionet e BQK-së sugjerojnë rritje ekonomike prej 3.9 përqind, me kontribuues kryesorë konsumin, investimet dhe eksportin e shërbimeve, ndërsa importi pritet të ketë ndikim negativ në rritjen ekonomike.

### 3.2. Çmimet

**Inflacioni në TM3 2025 u përshpejtua në 4.5 përqind, nga 3.7 përqind në tremujorin paraprak.** Ky përshpejtim u nxit nga rritja e çmimeve të ushqimit, energjisë elektrike dhe shërbimeve, ndërsa kontributi i mallrave tjera mbeti i pandryshuar (grafiku 8). Ecuri rritëse u evidentua edhe në inflacionin bazë, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të shërbimeve.

**Rritja vjetore e çmimeve të ushqimit u përshpejtua në 9.1 përqind në TM3 2025, krahasuar me 8.0 përqind në tremujorin paraprak, duke reflektuar ndikimin e zhvillimeve ndërkombëtare përmes kanalit të importit.** Sipas indeksit të çmimeve të importit, çmimet e produkteve shtazore dhe bimore u rritën për 8.0 dhe 2.4 përqind përkatësisht. Në tregun vendor, rritje më të theksuar shënuan çmimet e frutave (13.9 përqind), mishit (12.4 përqind), perimeve (8.7 përqind), vajrave ushqimore (8.4 përqind) dhe produkteve të bulmetit (7.8 përqind). Ndikim shtesë në rritjen e çmimeve të ushqimit pati edhe rritja e kostos së prodhimit në bujqësi prej 2.4 përqind. Si pasojë, u evidentuan presione inflacioniste në indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe blektorale që shënuan rritje prej 8.2 dhe 3.0 përqind respektivisht.


**Çmimet e karburanteve shënuan rënie vjetore prej 4.2 përqind. Megjithatë, në terma tremujorë, çmimet e tyre shënuan rritje prej 1.9 përqind,** duke reflektuar zhvillimet në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, çmimet e energjisë elektrike shënuan rritje vjetore prej 17.0 përqind, për shkak të rritjes së tarifave në vitin 2025. Çmimet e lëndëve të tjera djegëse vazhduan të bien në terma vjetorë, por norma e rënies u ngadalësua në -3.2 përqind (nga -4.7 përqind në tremujorin paraprak), si pasojë e afrimit të sezonit vjeshtor.

**Kontributi i ushqimit në normën mesatare të inflacionit u rrit në 2.4 pikë përqindje, kundrejt 2.1 p.p. në tremujorin paraprak.** Kontribuuesit kryesorë në inflacionin e ushqimit ishin rritja e çmimeve të mishit me 0.8 p.p., bulmetit me 0.4 p.p., frutave, perimeve, dhe bukës e drithërave me nga 0.3 p.p. Kontributi i energjisë rezultoi 0.2 p.p., duke kaluar në territor pozitiv pas katër tremujorëve me kontribut negativ. Kjo dinamikë u ndikua në shkallë pothuajse të njëjtë nga rënia e ngadalësuar e çmimeve të naftës dhe rritja e tarifave të energjisë elektrike. Kontributi i mallrave të tjera mbeti pothuajse i pandryshuar, ndërsa ai i shërbimeve u zgjerua për 0.2 p.p., kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të pakove turistike, shërbimeve gastronomike dhe atyre të transportit.

**Rritja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në inflacionin bazë, që rezultoi 2.1 përqind në TM3 2025** (grafiku 9). Megjithëse çmimet e ushqimit përjashtohen nga ky indeks, efekti i tyre u evidentua përmes rritjes së çmimeve të shërbimeve të gastronomisë që ishin kontribuuesi kryesor në inflacionin bazë. Ecuria rritëse e inflacionit bazë po ashtu reflekton rritjen e çmimeve të shërbimeve të transportit, atyre shëndetësore, rekreative dhe kulturore, arsimit dhe shërbimeve të komunikimit. Në anën tjetër, efekt në zbutjen e inflacionit bazë kishin rritja e ngadalësuar e çmimeve të veshmbathjes, orendive, strehimit dhe mallrave dhe shërbimeve të tjera.


**Origjina e presioneve inflacioniste në TM3 2025 pasqyron një kombinim faktorësh të jashtëm dhe të brendshëm.** Ushqimi dhe energjia ishin nxitësit kryesorë të inflacionit, dhe varësia nga importet ndikoi që ecuritë rritëse në tregjet ndërkombëtare të reflektohen në rritje të inflacionit të importuar në 3.5 p.p.

**Grafik 8. Inflacioni sipas kontributit të nëngrupeve përkatëse**



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

**Grafik 9. Inflacioni bazë dhe inflacioni i përgjithshëm i konsumit**



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Paralelisht, rritja e çmimeve të energjisë elektrike dhe shërbimeve kontribuoi në zgjerimin e inflacionit të brendshëm në 1.0 p.p.

**Indeksi i çmimeve të importit shënoi rënie vjetore prej 0.2 përqind në TM3 2025.** Rritje u evidentua në çmimet e produkteve shtazore (8.0 përqind) dhe atyre bimore (2.4 përqind), si dhe në çmimet e ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit të importuar (2.6 përqind). Në anën tjetër, përkundër rritjes së çmimeve të vajrave ushqyese dhe metaleve në tregjet ndërkombëtare, sipas këtij indeksi u shënuar rënie e çmimeve të vajrave ushqyese prej 2.7 përqind dhe metaleve bazë prej 4.7 përqind. Rënie vjetore u evidentua edhe në çmimet e produkteve minerale të importuara prej 2.2 përqind.

**Indeksi i çmimeve të prodhimit shënoi rritje vjetore prej 5.5 përqind në TM3 2025.** Nxitësit kryesor rezultuan çmimet e prodhimit të energjisë elektrike me rritje vjetore prej 20.8 përqind, përpunimi i produkteve ushqimore me rritje prej 3.1 përqind, prodhimi i produkteve minerale jometalike prej 0.4 përqind, dhe prodhimi i mobileve prej 7.8 përqind. Ndërsa, rënie e çmimeve u evidentua në industrinë nxjerrëse, prodhimin e metaleve, gomës dhe plastikës, dhe pijeve.

**Në TM3 2025, indeksi i kostos së ndërtimit rezultoi me rritje vjetore të ngadalësuar prej 3.6 përqind.** Ecuria e tij u përcaktua kryesisht nga çmimet e materialeve ndërtimore që shënuan rritje vjetore prej 2.9 përqind. Pagat, po ashtu, vijuan të ushtrojnë presione inflacioniste në këtë sektor, krahas energjisë elektrike, transportit dhe kostove tjera. Ndërsa, rënie u evidentua në çmimet e makinerive.

**Deri në nëntor, rritja vjetore e inflacionit arriti në 3.7 përqind. Sipas parashikimeve të BQK-së, viti 2025 pritet të mbyllet me normë mesatare të inflacionit rreth 3.8 përqind,** ndërsa në vitin 2026 pritet të ngadalësohet në 3.4 përqind. Ky ngadalësim pritet të mbështetet nga rënia e parashikuar e çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare dhe efekti bazë. Rreziqet kryesore ndaj këtij projeksioni lidhen me goditjet potenciale në ofertën e mallrave ushqimore dhe atyre energjetike në rast të përshkallëzimit të tensioneve gjeopolitike dhe kushteve klimatike, si dhe me zgjerimin e presioneve inflacioniste nga rritja e tarifave të energjisë elektrike në çmimet e mallrave dhe shërbimeve vendore.

### 3.3 Sektori Fiskal


**Sektori fiskal shënoi rritje gjatë TM3 2025, si në të hyra ashtu edhe në shpenzime buxhetore. Të hyrat primare buxhetore<sup>1</sup> arritën vlerën neto prej 892.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.8 përqind. Shpenzimet buxhetore<sup>2</sup> po ashtu shënuan rritje prej 7.3 përqind, duke arritur në 809.7 milionë euro. Si rezultat, suficiti primar buxhetor për TM3 2025 arriti vlerën prej 115.7 milionë euro.**

Të hyrat tatimore në TM3 2025 arritën në 798.5 milionë euro, duke shënuar rritje prej 10.3 përqind krahasuar me TM3 2024. Gjatë kësaj

periudhe, dy kategoritë kryesore të të hyrave tatimore, tatimet direkte dhe tatimet indirekte, patën trend pozitiv. Të hyrat nga tatimet direkte shënuan rritje prej 12.2 përqind, duke arritur në 134.5 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, të hyrat nga tatimi në të ardhurat e korporatave shënuan rritje prej 5.8 përqind, ndërsa të hyrat nga tatimi në të ardhurat personale shënuan rritje më të lartë prej 17.1 përqind, si rezultat i bazës së ulët krahasuese të vitit të kaluar. Tatimi në pronë pati rritje prej 10.5 përqind.

Tatimet indirekte, që përbëjnë pjesën më të madhe të të hyrave tatimore, shënuan rritje prej 7.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Brenda kësaj kategorie, mbizotërojnë të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), të cilat shënuan rritje prej 10.5 përqind, duke arritur në 446.2 milionë euro. Kjo rritje u mbështet kryesisht nga rritja nominale e importit prej 8.6 përqind, si dhe nga rritja e konsumit privat prej 5.1 përqind. Pas TVSH-së, të hyrat nga detyrimet doganore shënuan rritje prej 7.7 përqind, duke arritur në 51.1 milionë euro. Sipas raportimeve të Doganës, kjo rritje lidhet si me rritjen e vlerës së importit, ashtu edhe me reformat e ndërmarra në luftën kundër mashtrimit doganor dhe informalitetit. Ndërkohë, të hyrat nga akciza shënuan rritje të lehtë prej 1.6 përqind dhe arritën vlerën 186.6 milionë euro (grafiku 10), çka reflekton strukturën e importit gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë rritjen e ngadalësuar të importit të mallrave që janë subjekt i akcizës.

Grafik 10. Të hyrat tatimore sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: MFPT.


<sup>1</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga huazimet shtetërore.

<sup>2</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat për financim.

Të hyrat jo-tatimore shënuan rënie prej 9.8 përqind, duke arritur në 92.5 milionë euro. Brenda kësaj kategorie, të hyrat nga qeveria qendrore shënuan rënie prej 12.1 përqind, duke arritur në 47.5 milionë euro, ndërsa të hyrat nga qeveria lokale shënuan rritje për 24.4 përqind, duke arritur në 22.1 milionë euro.

Sa i përket shpenzimeve buxhetore, shpenzimet rrjedhëse shënuan rritje prej 5.9 përqind. Brenda kësaj kategorie, shpenzimet për paga shënuan rritje prej 1.6 përqind, duke arritur në 197.3 milionë euro. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, përfshirë shpenzimet komunale, shënuan rritje prej 7.6 përqind dhe arritën vlerën prej 107.6 milionë euro. Ndërsa, shpenzimet për subvencione dhe transfere shënuan rënie prej 2.6 përqind, duke arritur vlerën 302.6 milionë euro. Baza e lartë nga viti i kaluar është faktori kryesor shpjegues i kësaj rënieje, duke qenë se niveli i përgjithshëm i shpenzimeve në këtë kategori vazhdon të jetë i lartë. Shpenzimet kapitale shënuan rritje prej 14.0 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke arritur në 146.0 milionë euro (grafiku 11).

Grafik 11. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive, në milionë euro



Burimi: MFPT.


**Raporti i borxhit publik ndaj BPV-së u rrit në 16.0 përqind në TM3 2025, krahasuar me 15.5 përqind në TM3 2024.** Kjo rritje e lehtë ishte si rezultat i rritjes së borxhit të jashtëm publik, ndërsa borxhi i brendshëm u zvogëlua. Në terma absolutë, borxhi publik ishte 1.77 miliardë euro në TM3 2025, duke shënuar rritje prej 8.8 përqind krahasuar me TM3 2024. Borxhi i jashtëm publik u rrit për 22.1 përqind, duke arritur vlerën 849.4 milionë euro, ndërsa borxhi i brendshëm publik u zvogëlua për 11.0 përqind, duke arritur në 921.2 milionë euro.

Borxhi i jashtëm publik përfshin detyrime financiare ndaj institucioneve ndërkombëtare, si Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim (me 32 përqind të borxhit të jashtëm), Fondi Monetar Ndërkombëtar (20 përqind), Bashkimi Evropian (12 përqind), Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (8 përqind), etj. Ndërsa, borxhi i brendshëm publik përfshin kryesisht borxhin e Qeverisë së Kosovës (letrat me vlerë) ndaj fondeve pensionale (41 përqind), bankave komerciale (25 përqind) dhe institucioneve publike (24 përqind).

### 3.4. Sektori i jashtëm

**Për dallim nga dinamikat e gjysmës së parë të vitit 2025, llogaria rrjedhëse në TM3 2025 shënoi bilanc pozitiv prej 230.7 milionë euro, por me rënie vjetore prej 6.7 përqind (grafik 12).** Ky zhvillim lidhet kryesisht me rritjen e deficitit tregtar të mallrave, i cili vazhdon të mbetet faktori kryesor përcaktues i llogarisë rrjedhëse. Ndikimi negativ nga tregtia e mallrave u kompensua nga performanca pozitive e komponentëve të tjerë, duke bërë që bilanci përfundimtar të jetë pozitiv. Veçanërisht, bilanci i shërbimeve, i mbështetur kryesisht nga shërbimet e udhëtimit, së bashku me të ardhurat parësore dhe dytësore, kontribuan në ruajtjen e bilancit pozitiv të llogarisë rrjedhëse.


Grafik 12. Llogaria rrjedhëse, në milionë euro



Burimi: BQK.

**Deficiti tregtar i mallrave u thellua me 13.2 përqind, duke arritur në 1.6 miliardë euro (grafik 13).** Ky thellim pasqyron kryesisht rritjen e importit, duke arritur në 1.9 miliardë euro, nxitur nga rritja e kërkesës në vend. Në anën tjetër, eksporti mbeti në nivel të ulët, me vlerë prej 245.8 milionë euro, duke mbuluar vetëm 13.1 përqind të importit. Ky raport i pafavorshëm tregon për varësinë e lartë të ekonomisë nga importi dhe për kapacitetet e kufizuara eksportuese, duke ekspozuar ekonominë ndaj luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare dhe rreziqeve të jashtme.


Grafik 13. Bilanci tregtar i mallrave



Burimi: ASK.


**Eksporti i mallrave shënoi rënie të lehtë prej 0.5 përqind në TM3 2025, kryesisht për shkak të performancës së dobët të disa prej kategorive kryesore, përfshirë produktet minerale dhe metalet bazë** (grafik 14). Produktet minerale shënuan rënie prej 20.2 përqind, duke dhënë kontribut negativ prej 2.8 pikë përqindje në performancën e përgjithshme të eksporteve, kryesisht si pasojë e rënies së eksportit të energjisë elektrike. Metalet bazë shënuan rënie prej 11.1 përqind, duke kontribuar me -2.5 pikë përqindje në gjithsej eksportin, ndikuar nga dobësimi i kërkesës së jashtme dhe sfidat e prodhimit në vend. Në anën tjetër, artikujt ushqimorë, produktet e plastikës (përfshirë gomën) dhe produktet bimore kontribuuan pozitivisht, duke zbutur pjesërisht rënien e përgjithshme të eksportit. Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor tregtar, me 48.1 përqind të gjithsej eksporteve, me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut si destinacionet kryesore. Vendet e BE-së përbëjnë 32.6 përqind të eksportit të përgjithshëm, me destinacionin kryesor Gjermaninë. Kjo strukturë tregon varësi të theksuar ndaj tregut rajonal, por gjithashtu një mundësi për zgjerim dhe integrim në zinxhirët globalë të furnizimit.

Garfik 14. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.

Garfik 15. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: BQK.


**Importi i mallrave shënoi rritje prej 11.2 përqind, duke arritur në 1.9 miliardë euro, i nxitur kryesisht nga rritja e sasisë së mallrave të importuara që pasqyron rritje të kërkesës në vend.**

Rritja ishte e përqendruar kryesisht te mallrat konsumuese (14.7 përqind) dhe mallrat e ndërmjetme (10.6 përqind), ndërsa mallrat kapitale mbetën në nivel të pandryshuar. Sipas kategorive kryesore, importi i produkteve minerale kontribuoi me 2.5 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rritjes së importit të energjisë elektrike. Kategoria e mjeteve të transportit kontribuoi ndjeshëm në këtë rritje me 2.1 pikë përqindje, ndikuar nga ulja e tarifave doganore për automjetet nga Koreja e Jugut. Po ashtu, importi i artikujve ushqimorë kontribuoi me 1.0 pikë përqindje, i nxitur nga kërkesa e qëndrueshme për konsum (grafik 15). Gjeografikisht, vendet e BE-së përfaqësojnë rreth 42.3 përqind të importeve, ndjekur nga Kina me 14.9 përqind dhe vendet e rajonit me 13.1 përqind të importeve.

**Bilanci i shërbimeve arriti në 1.1 miliardë euro, duke regjistruar rritje vjetore prej 14.0 përqind (34.9 përqind e BPV-së).**

Eksporti i shërbimeve arriti në 1.7 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 9.0 përqind, mbështetur kryesisht nga shërbimet e udhëtimit, të cilat u rritën me 8.0 përqind dhe arritën në 1.4 miliardë euro, si rezultat i rritjes së numrit të udhëtarëve dhe vizitave nga diaspora. Nga ana tjetër, importi i shërbimeve arriti vlerën prej 563.0 milionë euro, duke shënuar rritje modeste prej vetëm 0.3 përqind. Brenda kësaj kategorie, importi i shërbimeve të udhëtimit u rrit me 6.6 përqind, dhe transportit me 5.4 përqind. Diferenca e lartë ndërmjet eksportit dhe importit të shërbimeve bëri që bilanci të rezultojë pozitiv (grafik 16), ku roli i diasporës ishte veçanërisht i rëndësishëm.

Grafik 16. Bilanci i shërbimeve




Burimi: BQK.

Bilanci të rezultojë pozitiv (grafik 16), ku roli i diasporës ishte veçanërisht i rëndësishëm.

**Bilanci i të ardhurave parësore shënoi përmirësim të ndjeshëm, duke arritur vlerën prej 72.5 milionë euro, ose rritje prej 38.4 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (grafik 17). Ky zhvillim pasqyron kryesisht rritjen e vazhdueshme të kompensimit të punëtorëve, me rritje vjetore prej 9.6 përqind duke arritur në 115.8 milionë euro. Kjo rritje sugjeron intensifikim të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore rezidente në tregun e jashtëm të punës, duke kontribuar në forcimin e të ardhurave hyrëse dhe stabilizimin e llogarisë rrjedhëse. Nga ana tjetër, bilanci i të ardhurave nga investimet mbeti negativ, në vlerë prej 44.3 milionë euro, kryesisht për shkak të fitimit të riinvestuar nga investitorët e huaj.**


Grafik 17. Bilanci i të ardhurave parësore



Burimi: BQK.

**Remitencat në TM3 2025 arritën vlerën prej 393.7 milionë euro (12.6 përqind e BPV-së), duke shënuar rritje prej 3.4 përqind (grafik 18). Për më tepër, ky trend shënoi përshejtim krahasuar me vitin paraprak, kur rritja ishte vetëm 1.8 përqind në TM3 2024, e mbështetur kryesisht nga rritja e numrit të udhëtarëve dhe vizitave nga diaspora gjatë kësaj periudhe. Rritje u regjistrua si në kanalet formale, të cilat shënuan rritje prej 3.7 përqind dhe në kanalet joformale, me rritje prej 2.9 përqind. Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave (55.4 përqind të totalit), pastaj SHBA-të dhe vendet e tjera të BE-së. Megjithatë, duke konsideruar se pjesa më e madhe e remitancave të pranuar në Kosovë kanë origjinë nga vendet e Bashkimit Evropian, zhvillimet në aktivitetin ekonomik të këtyre vendeve, si dhe pasiguritë e shtuara, përfshirë tensionet gjeopolitike dhe tregtare, përbëjnë faktorë të rëndësishëm për trendin e rritjes.**


Grafik 18. Remitencat



Burimi: BQK.

**Investimet e huaja direkte (IHD) arritën në 298.7 milionë euro në TM3 2025, duke shënuar rritje vjetore prej 20.6 përqind (grafik 19). Ato u përqendruan kryesisht në sektorin e patundshmërisë, i cili përbënte 75.8 përqind të gjithsej IHD-ve dhe arritën vlerën prej 226.5 milionë euro. Rritja u ndikua kryesisht nga kërkesa e diasporës dhe rritja e çmimeve të pasurive të paluajtshme në vend. Krahas kësaj, është shënuar rritje e IHD-ve në aktivitetet financiare, sigurime, tregti dhe xehtari. Në anën tjetër, investimet direkte të rezidentëve nga Kosova jashtë vendit arritën 106.6 milionë euro, pothuajse dyfish më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, duke reflektuar rritje të interesit për investime në vendet e rajonit dhe diversifikim të kapitalit.**

Grafik 19. Investimet e huaja direkte




Burimi: BQK.

duke reflektuar rritje të interesit për investime në vendet e rajonit dhe diversifikim të kapitalit.

## 4. Sistemi financiar

**Sistemi financiar në vend shënoi rritje vjetore të përshpejtuar për tremujorin e tretë radhazi të vitit 2025.** Vlera e aseteve të sistemit financiar arriti në 13.82 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 15.3 përqind, krahasuar me 13.3 përqind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (grafik 20). Dinamika e zhvillimeve sipas sektorëve mbeti e njëjtë nga pjesa e parë e vitit; sektori bankar dhe ai i ndihmësve financiar shënuan rritje vjetore të përshpejtuar, ndërsa fondet pensionale, sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore.


**Grafik 20. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës**



Burimi: BQK.

Zhvillimi i sistemit financiar mbetet kryesisht i mbështetur nga sektori bankar, i cili përfaqëson rreth dy të tretat (66.2 përqind) të total aseteve të sistemit deri në shtator 2025 (grafik 21). Fondet pensionale, si sektori i dytë për nga pesha në sistem, shënuan rritje vjetore të ngadalësuar prej 16.9 përqind nga 17.7 përqind në vitin paraprak, kryesisht si rezultat i bazës së lartë nga viti i kaluar. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre në totalin e aseteve të sistemit u rrit në 26.1 përqind, apo rritje prej 0.4 pikë përqindje nga një vit më parë. Po ashtu, sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar ngadalësuan ritmin e rritjes, përkatësisht shënuan rritje prej 5.7 përqind dhe 18.6 përqind, krahasuar me 12.5 përqind dhe 27.5 përqind. Megjithatë, sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar arriti të rrisë lehtë pjesëmarrjen e tij në sistem për shkak të shkallës relativisht më të lartë të rritjes, duke u zgjeruar në 5.1 përqind nga 4.9 përqind. Kurse, sektori i sigurimeve shënoi rënie të pjesëmarrjes me 0.2 pikë përqindje, duke zbritur në 2.6 përqind. Sektori i ndihmësve financiar ka vazhduar të rritet me ritëm të përshpejtuar, ashtu si në pjesën tjetër të vitit, duke shënuar rritje prej 26.1 përqind. Ky zhvillim vjen pas rënies së theksuar prej 63.4 përqind në vitin e kaluar, e cila ishte rezultat i riklasifikimit të dy operatorëve nga kategoria e ndihmësve financiarë në kategorinë IMF/IFJB. Megjithatë, për shkak të peshës së ulët në sistemin financiar, kontributi i këtij sektori në rritjen e përgjithshme vazhdoi të jetë minimal.

**Grafik 21. Kontributi në rritje i aseteve të sistemit financiar, në pikë përqindje**




Burimi: BQK.

### 4.1. Sektori bankar

Asetet e sektorit bankar arritën në 9.14 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 14.8 përqind, krahasuar me 11.2 përqind në shtator të vitit të kaluar (grafik 22). Ky përshpejtim është nxitur kryesisht nga zgjerimi i kreditimit, si aktivitetit kryesor i sektorit, me pjesëmarrje prej 70.6 përqind të totalit të aseteve. Kontribut pozitiv dhanë edhe paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në, të cilat u rritën me 16.6 përqind nga 2.2 përqind një vit më parë. Ndërsa, kategoria e letrave me vlerë u karakterizua me rritje vjetore prej 10.8 përqind, të ngadalësuar për 3.4 pikë përqindje nga shtatori i vitit të kaluar. Ky zhvillim pasqyron ngadalësimin e investimeve në letra me vlerë të huaja në 10.1 përqind, nga 21.2 përqind rritje një vit më parë. Kurse, investimet në letra me vlerë vendore shënuan rritje të përshpejtuar prej 13.5 përqind, pas rënies prej 5.4 përqind në vitin e kaluar. Zëri i vetëm që u karakterizua me tkurje ishte ai i bilanci me bankat komerciale, duke shënuar rënie prej 0.3 përqind nga 10.1 përqind në vitin paraprak.

**Grafik 22. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet**



Burimi: BQK.

**Në TM3 2025, stoku i gjithsej kredive arriti në 6.45 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 17.0 përqind, nga 15.1 përqind në shtatorin e vitit paraprak (grafik 23). Ndërsa, në krahasim tremujor, ritmi i rritjes është ngadalësuar për 2.3 pikë përqindje. Këto zhvillime reflektojnë**

rritjen e lartë të kredive të reja në tremujorin e parë të këtij viti, ndryshe nga tremujori i dytë dhe i tretë, ku kreditë e reja u karakterizuan me rënie në terma tremujorë.

**Sipas Anketës së Kreditimit Bankar për TM3 2025, ashtu si në tremujorin paraprak, ngadalësimi i ritmit të rritjes së kreditimit reflekton ndër të tjera shtrëngimin e ofertës kreditore, si për ekonomitë familjare ashtu edhe për korporatat jofinanciare.** Më konkretisht, oferta kreditore u shtrëngua deri në një masë për ekonomitë familjare në përgjithësi, si për kreditë për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë personale/konsumuese. Ndërsa për ndërmarrjet, shtrëngimi ishte pak më i theksuar tek ndërmarrjet e mëdha. Në kuadër të kushteve dhe rregullave, u raportua për shtrëngim në normën e interesit dhe madhësinë mesatare të kredisë, për të dy segmentet, ndërsa për segmentin e ekonomive familjare u deklarua për shtrëngim edhe në maturitet. Faktorët kryesor që përcaktuan shtrëngimin e ofertës kreditore ishin toleranca më e ulët e bankave ndaj rrezikut, qasja në gjithësinë financim, kufizimet në kapacitetin e bankave dhe perceptimet lidhur me perspektivën ekonomike në tregun vendor.


**Kërkesa për kredi kishte zhvillime të ndryshme ndërmjet segmenteve.** Për ekonomitë familjare, kërkesa mbeti kryesisht e pandryshuar, karakterizuar me rënie deri në një masë për kreditë personale/konsumuese. Ndërsa për segmentin e ndërmarrjeve, kishte rritje deri në një masë për NVM-të dhe kërkesë kryesisht të pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha. Faktorët kryesorë që ndikuan kërkesën kreditore ishin financimi i inventarëve dhe kapitalit punues për ndërmarrjet, ndërsa për ekonomitë familjare ndikuan shpenzimet e konsumit. Në TM4 2025, bankat presin lehtësim të standardeve kreditore për të dy segmentet. Kërkesa për kredi pritet të jetë më e lartë nga ndërmarrjet, ndërsa për ekonomitë familjare pritet të mbetet në nivele të ngjashme me tremujorin aktual.

**Të dhënat e portofolit tregojnë se rritja vjetore e gjithësinë kredive është mbështetur pothuajse në mënyrë të barabartë nga dy segmentet kryesore: korporatat jofinanciare dhe ekonomitë familjare** (grafik 24). Kreditë ndaj KJF-ve vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithësinë kredive, me pjesëmarrje prej 57.2 përqind. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre ka shënuar rënie graduale në pesë vitet e fundit në favor të segmentit të ekonomive familjare, duke reflektuar orientimin e tregut drejt zgjerimit të kreditimit për individët dhe pasuritë e paluajtshme.

**Zgjerimi i aktivitetit kreditues reflektohet edhe në rritjen e përsheptuar të numrit të kredimarrësve të rinj.** Sipas Regjistrimit të Kredive, numri i kredimarrësve të rinj për periudhën janar - shtator 2025 arriti në 18,752 individë, apo rritje prej 13.3 përqind nga 5.0 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke treguar për thellim të mëtijshëm të ndërmjetësimit financiar.<sup>3</sup>


**Kreditë për korporatat jofinanciare arritën në 3.69 miliardë euro, me rritje vjetore të përsheptuar në 14.0 përqind, krahasuar me 11.2 përqind në shtatorin e vitit paraprak.** Në terma tremujorë, megjithatë, u shënuar rënie e kreditimit, e ndikuar nga ulja e kredive të reja. Dinamika e rritjes vjetore të gjithësinë kredive ndaj KJF-ve u ndikua nga rritja e kredive të reja investuese, ndërsa ato jo-investuese shënuan rënie për vitin e dytë me radhë. Gjithësinë kredite të reja të lëshuara deri në TM3 2025 ndaj KJF-ve arritën në 1.10 miliardë euro, duke shënuar

Grafik 23. Stoku i gjithësinë kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Grafik 24. Kontributi në rritjen e gjithësinë kredive, në pikë përqindje



Burimi: BQK.

Grafik 25. Kontributi në rritjen e gjithësinë kreditimit për korporatat jofinanciare, sipas aktivitetit ekonomik




Burimi: BQK.

<sup>3</sup> Numri i kredimarrësve të rinj në databazën e Regjistrimit të Kredive të Kosovës.

rritje vjetore prej 13.0 përqind nga 5.5 përqind në vitin e kaluar. Në kuadër të kredive të reja, ato investuese shënuan rritje prej 25.9 përqind nga 19.3 përqind në vitin e kaluar. Ndërsa, kreditë e reja jo-investuese shënuan rënie prej 5.6 përqind nga 12.5 përqind. **Megjithatë, në krahasim tremujor, stoku i gjithsej kredive ndaj KJF-ve ka shënuar rënie prej 0.4 përqind, si rezultat i rënies së kredive të reja për tremujorin e dytë radhazi.** Më konkretisht, kreditë e reja ndaj KJF-ve shënuan rënie prej 11.9 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, ndikuar nga rënia e kredive të reja investuese me 20.7 përqind. Në anën tjetër, kreditë jo-investuese shënuan rritje prej 9.7 përqind, duke neutralizuar deri në një masë rënien e gjithsej kredive të reja nga tremujori i kaluar.

**Aktiviteti kreditues i KJF-ve është karakterizuar nga zhvillime të ndryshme ndërmjet sektorëve ekonomikë.** Më konkretisht, në sektorin e tregtisë është ngadalësuar ritmi i rritjes vjetore të kreditimit në 11.1 përqind, nga 12.9 përqind sa ishte një vit më parë. Megjithatë, tregtia mbetet sektori dominues në portofolin e kredive, me pjesëmarrje prej 41.2 përqind. Në anën tjetër, kreditimi në sektorin e prodhimit ka shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 22.2 përqind, nga vetëm 0.2 përqind në vitin paraprak, duke u bërë kështu kontribuuesi i dytë në rritjen e gjithsej kredive (grafik 25). Ngjashëm, edhe në shërbimet


**Grafik 26. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike**



financiare kreditimi ka përshpejtuar ritmin e rritjes, duke shënuar rritje prej 24.7 përqind nga 18.0 përqind në vitin paraprak (grafik 26). Sektorin e energjetikës, trajtimin të ujërave dhe të tjera ka shënuar gjithashtu rritje vjetore të përshpejtuar, apo rritje prej 78.0 përqind, pas rënies prej 11.6 përqind në vitin paraprak, dinamike kjo e ndikuar nga rritja e lartë e kredive për këtë sektor në muajin shtator të këtij viti dhe efektit të bazës së ulët krahasuese. Në anën tjetër, kreditimi në sektorin e bujqësisë ka shënuar rënie prej 4.8 përqind, krahasuar me rritjen prej 15.4 përqind në vitin paraprak. Zhvillimet në kreditim pasqyrohen pjesërisht edhe në të dhënat e ATK-së mbi qarkullimin sipas sektorëve. Të dhënat për prodhimin dhe energjetikën pasqyrojnë një rritje të përshpejtuar të qarkullimit, në linjë me kreditimin deri në TM3 2025, ndërsa në sektorët e tjerë, qarkullimi dhe kreditimi kanë ndjekur dinamika të ndryshme.

**Stoku i kredive për ekonomitë familjare arriti në 2.69 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore lehtësisht të ngadalësuar në 20.6 përqind nga 20.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Dinamika e rritjes së kredive ndaj ekonomive familjare u ndikua nga rritja e lartë e kredive të reja hipotekare, me theks të veçantë në tremujorin e parë të vitit, ndërsa në tremujorin e tretë aktiviteti i përgjithshëm kreditues i ekonomive familjare vazhdoi ngadalësimin që filloi nga tremujori i dytë i vitit 2025. Deri në shtator 2025, gjithsej kreditë e reja për segmentin e ekonomive familjare arritën në 921.8 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 4.8 përqind nga 32.0 përqind në shtatorin e vitit paraprak. Më konkretisht, kreditë e reja hipotekare shënuan rritje prej 38.1 përqind nga 27.3 përqind një vit më parë (grafik 27). Ndërsa, kreditë e reja konsumuese shënuan rënie prej 1.9 përqind nga 35.5 përqind rritje në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

**Grafik 27. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor**




**Megjithatë, në krahasim tremujor, kreditë e reja hipotekare shënuan rënie për tremujorin e dytë me radhë, duke u tkurrur me 19.7 përqind në TM3 2025. Po ashtu, për dallim nga rritja në tremujorin paraprak, kreditë e reja konsumuese shënuan rënie prej 26.8 përqind.** Rritja e lartë vjetore e kredive hipotekare është reflektuar edhe në strukturën e maturimit të stokut të kredive për ekonomitë familjare, duke shënuar rritje të kredive me afate më të gjata. Konkretisht, kreditë me maturitet 'mbi 10 vite' zgjeruan pjesëmarrjen në 37.8 përqind, nga 36.0 përqind një vit më parë, ndërsa kategoritë e tjera me maturitet deri në 10 vite shënuan rënie të pjesëmarrjes në gjithsej portofolion e kredive. Megjithatë, kategoria dominuese vazhdoi të jetë ajo e maturitetit '5 - 10 vite', me pjesëmarrje prej 42.7 përqind të portofolios.

**Ndryshe nga zhvillimet në stokun e kredive, kreditë e reja treguan tendencë të rënies mesatare të maturitetit dhe vlerës mesatare të disbursuar.** Sipas të dhënave nga databaza e Regjistrimit të Kredive të Kosovës (RKK), afati mesatar i maturimit të kredive të reja të lëshuara në periudhën janar-shtator 2025 ka shënuar rënie nga viti paraprak, duke zbritur në 3.7 vite nga 5.0 vite. Këto zhvillime janë në linjë me rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar në Kosovë, sipas së cilës bankat kanë shtrënguar kushtet e kreditimit, përfshirë kufizimet në maturitetin e kredive të reja për ekonomitë familjare. Ndërsa, vlera mesatare e kredive të reja


ishite 7.2 mijë euro, ngjashëm me 7.3 mijë euro në TM2 2025, mirëpo dukshëm më e ulët krahasuar me 10.5 mijë euro në tremujorin e tretë të vitit të kaluar.

**Grafik 28a. Kreditë e reja të EF sipas vlerës së disbursuar në RKK (%)**



Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.


**Grafik 28b. Kreditë e reja të EF sipas maturitetit në RKK (%)**



Burimi: Regjistri i Kredive të Kosovës.


Më konkretisht, në aspekt të vlerës së kredive të reja të lëshuara gjatë kësaj periudhe, 34.7 përqind e tyre ishin në intervalin prej ‘500 euro – 10 mijë euro’, duke u pozicionuar si kategori dominuese. Kjo paraqet një ndryshim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, kur dominonin kreditë në intervalin ‘10 mijë - 30 mijë euro’, me pjesëmarrje prej 35.0 përqind (grafik 28a). Në aspekt të maturitetit, kategoria kryesore mbetet ajo me maturitet ‘5-10 vite’, duke përfaqësuar 31.8 përqind të gjithsej kredive të reja, megjithëse pjesëmarrja e saj ka rënë me 5.9 pikë përqindje nga viti paraprak (grafik 28b). Rënie të pjesëmarrjes në kreditë e reja të lëshuara deri në shtator 2025 shënuan edhe kategoritë e tjera me maturitet mbi 10 vite, ndërsa u shënuan rritje e pjesëmarrjes së kredive me maturitet deri në 5 vite.

**Grafik 29. Stoku i gjithsej depozitave**



Burimi: BQK.


**Grafik 29a. Diferenca (mil. €) dhe ndryshimi i vlerës (%) së depozitave në kuartale**



Burimi: BQK.

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2025, stoku i depozitave në sektorin bankar arriti në 7.34 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të përshpejtuar prej 12.8 përqind nga 11.2 përqind (grafik 29). Po ashtu, krahasuar me tremujorin paraprak, depozitat u rritën me 6.4 përqind. Dinamika e rritjes tremujore të depozitave ishte në përputhje me sezonalitetin karakteristik të pjesës së dytë të vitit i cili historikisht është shoqëruar me rritje të dukshme të depozitave (grafik 29a). Depozitat e ekonomive familjare vazhduan të jenë kontribuuesi kryesor në rritjen e stokut të gjithsej depozitave, kjo falë ritmit të përshpejtuar të rritjes dhe peshës së lartë prej 65.5 përqind në kuadër të gjithsej depozitave. Deri në shtator 2025, stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti vlerën prej 4.81 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 14.5 përqind nga 8.0 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, depozitat e korporatave jofinanciare arritën në 1.54 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 10.4 përqind, nga 14.4 përqind në vitin paraprak. Depozitat e korporatave financiare, për dallim nga shtatori i vitit paraprak, këtë vit shënuan rritje të përshpejtuar prej 32.3 përqind, krahasuar me 17.4 përqind në shtator 2024 (grafik 30). Në anën tjetër, depozitat e korporatave publike, u karakterizuan me rënie vjetore prej 20.4 përqind, pas rritjes prej 51.6 përqind një vit më parë. Rënia e depozitave të korporatave publike është ndikuar kryesisht nga depozitorët e mëdhenj, veçanërisht nga sektori i energjisë, në kushtet e rritjes së importit të energjisë elektrike. Në shtator 2025, depozitat përbënin 80.3 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit bankar, duke shënuar rënie vjetore për 1.4 pikë përqindje, kryesisht si rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së bilancit nga bankat komerciale, burimeve vetanake dhe borxhit të ndërvarur.


**Grafik 30. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje**



Burimi: BQK.

**Depozitat e reja, që përfshijnë vetëm depozitat e afatizuara, arritën në 1.10 miliardë euro deri në TM3 2025, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 31.3 përqind, nga 35.6 përqind një vit më parë, si pasojë e efektit të bazës së lartë në vitin paraprak. Ky zhvillim u ndikua nga rritja e ngadalësuar e depozitave të reja në të dy segmentet – ekonomi familjare dhe korporata jofinanciare. Më konkretisht, segmenti i ekonomive familjare ka shënuar rritje vjetore prej 34.1 përqind nga 39.1 përqind në shtatorin e vitit të kaluar dhe mbetet kontribuuesi kryesor në rritjen e gjithsej depozitave të reja. Po ashtu, depozitat e reja të korporatave jofinanciare shënuan rritje të ngadalësuar prej 24.4 përqind nga 27.5 përqind në vitin e kaluar (grafik 31).**


**Grafik 31. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor**



Burimi: BQK.

**Norma mesatare e interesit në kredi në TM3 2025 vazhdoi trendin rritës që e karakterizoi edhe në tremujorin e dytë. Po ashtu, norma e interesit në depozita, ndryshe nga tremujori paraprak, ka shënuar rritje, duke reflektuar konkurrencën e rritur mes bankave për financim nga depozitat. Më konkretisht, në shtator 2025, norma e interesit në kredi arriti në 6.9 përqind nga 6.3 përqind në qershor 2025, apo rritje për 0.8 pikë përqindje krahasuar me shtatorin e vitit të kaluar. Ndërsa, norma e interesit në depozita ka arritur në 3.1 përqind, nga 2.7 përqind në qershor 2025 dhe 2.9 përqind në shtatorin e vitit paraprak. Si rezultat i rritjes më të lartë të normës së interesit në kredi krahasuar me atë në depozita, hendeku i normës kredi – depozitë ka arritur në 3.8 pikë përqindje, apo rritje për 0.2 pikë përqindje nga tremujori paraprak dhe për 0.6 pikë përqindje krahasuar me shtatorin 2024 (grafik 32).**


**Grafik 32. Norma e interesit në kredi dhe depozita**



Burimi: BQK.

**Struktura e kredive sipas llojit të normave të interesit ka vazhduar të karakterizohet me trendin e rritjes së kredive me normë fikse të interesit. Më konkretisht, në shtator 2025, pjesëmarrja e kredive me normë fikse të interesit arriti në 71.8 përqind nga 69.4 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa, nga tremujori paraprak, struktura ka mbetur pothuajse e njëjtë, duke shënuar rritje marginale të pjesëmarrjes së kredive fikse prej 0.1 pikë përqindje (grafik 33).**


**Grafik 33. Stoku i kredive sipas llojit të normave të interesit**



Burimi: BQK.


**Norma mesatare e interesit në kredi ndaj korporatave jofinanciare arriti në 6.9 përqind, duke shënuar rritje për 0.6 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dhe 0.4 pikë përqindje krahasuar me qershorin e këtij viti. Në kuadër të KJF-ve, norma mesatare e interesit për sektorin e industrisë dhe shërbimeve, ka shënuar rritje si në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ashtu edhe krahasuar me fundin e tremujorit paraprak, duke arritur në një mesatare prej 7.0 përqind dhe 6.6 përqind, respektivisht (grafik 34). Në aspekt të sektorëve ekonomik, rritjen më të lartë e ka shënuar norma e interesit për sektorin e bujqësisë, e cili arriti në 8.9 përqind.**

**Grafik 34. Norma e interesit në kredi për korporatat jo-financiare**



Burimi: BQK.

**Grafik 35. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare**




Burimi: BQK.

**Norma mesatare e interesit për ekonomitë familjare arriti në 6.9 përqind, duke shënuar rritje për 1.1 pikë përqindje nga viti paraprak dhe 0.8 pikë përqindje nga qershori i këtij viti.** Në kuadër të ekonomive familjare, me rritje më të theksuar të normës së interesit u karakterizuan kreditë konsumuese, duke arritur në 7.4 përqind, nga 6.3 përqind në qershor të këtij viti dhe 6.0 përqind në shtator të vitit paraprak. Ndërsa, norma e interesit për kreditë hipotekare arriti në 5.8 përqind, përkatësisht rritje prej 0.8 pikë përqindje nga një vit më parë dhe 0.4 pikë përqindje më shumë krahasuar me fundin e tremujorit të kaluar (grafik 35).

**Në kuadër të depozitave,** norma mesatare e interesit në depozita për ekonomitë familjare arriti në 3.1 përqind, duke shënuar rritje vjetore për 0.2 pikë përqindje dhe rritje për 0.5 pikë përqindje nga qershori i këtij viti (grafik 36). Për korporatat jofinanciare, norma mesatare e interesit në depozita ka shënuar rritje vjetore për 0.3 pikë përqindje, duke arritur në 3.3 përqind. Ndërsa, krahasuar me qershorin e këtij viti, kjo normë ka shënuar rënie për 0.2 pikë përqindje.


**Grafik 36. Normat e interesit për depozita**



Burimi: BQK.

**Fitimi neto i sektorit bankar në fund të TM3 2025 ishte 137.2 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 1.0 përqind, pas rritjes prej 12.1 përqind një vit më parë.** Kjo dinamikë reflekton rritjen më të ngadalësuar të të hyrave në raport me rritjen e shpenzimeve. Të hyrat totale arritën në 407.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.1 përqind nga 17.7 përqind një vit më parë. Ngadalësimi i rritjes së të hyrave u ndikua kryesisht nga të hyrat nga interesi, të cilat përbëjnë rreth 76.9 përqind të gjithsej të hyrave dhe shënuan rritje prej 11.2 përqind nga 20.0 përqind në vitin e kaluar. Më konkretisht, të hyrat nga interesi në kredi u rritën me 12.9 përqind nga 23.9 përqind, kryesisht si rezultat i ngadalësimit të kredive të reja krahasuar me vitin paraprak dhe aplikimit të normave më të ulëta të interesit në tremujorin e parë të këtij viti, periudhë gjatë së cilës kreditë e reja u rritën me ritëm të lartë. Të hyrat nga investimet në letra me vlerë shënuan rritje të përshpejtuar prej 43.8 përqind nga 1.7 përqind një vit më parë. Ndërsa, të hyrat nga plasmanët me bankat ka shënuar rënie për vitin e dytë me radhë, duke zbritur në 11.7 milionë euro nga 18.7 milionë euro në shtator të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i rënies së bilancit me bankat komerciale. Kategoria e të hyrave nga jo interesi - e që janë kryesisht të hyra nga tarifat dhe komisionet – arritën vlerën prej 84.1 milionë euro deri në fund të shtatorit 2025, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 7.0 përqind nga 9.7 përqind një vit më parë, kryesisht si rezultat i rënies së të hyrave tjera operative për 2.1 milionë euro.

**Grafik 37. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar**



Burimi: BQK.

**Shpenzimet e sektorit arritën në 269.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të ngadalësuar prej 15.1 përqind nga 21.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.** Ky zhvillim u ndikua kryesisht nga ecuria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, të cilat ngadalësuan ritmin e rritjes në 8.1 përqind nga 19.5 përqind, dhe arritën vlerën prej 142.9 milionë euro. Shpenzimet e interesit gjithashtu ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore në 32.4 përqind nga 43.9 përqind, si rezultat i bazës së lartë nga viti paraprak. Në anën


tjetër, shpenzimet e jointeredit shënuan rritje të përshpejtuar prej 27.6 përqind krahasuar me 9.0 përqind në vitin paraprak.

**Treguesit e profitabilitetit shënuan rënie krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i zgjerimit më të shpejtë të aseteve dhe kapitalit në raport me fitimin.** Më konkretisht, treguesi i Kthimit në Kapital zbriti në 17.4 përqind nga 19.2 përqind një vit më parë, ndërsa Kthimi në Asete ka shënuar rënie vjetore për 0.3 pikë përqindje, duke zbritur në 2.3 përqind (grafik 37).

**Raporti i kredive jo-performuese arriti në 2.1 përqind, duke shënuar rritje marginale prej 0.05 pikë përqindje nga tremujori paraprak, ndërsa mbeti i pandryshuar në terma vjetor.**

Ky zhvillim nga tremujori paraprak reflekton rritjen e përshpejtuar të kredive jo-performuese në raport me rritjen e ngadalësuar të gjithsej kredive (grafik 38). Konkretisht, vlera e kredive jo-performuese arriti në 132.3 milionë euro, duke shënuar rritje prej 3.4 përqind nga qershori i këtij viti, ndërsa gjithsej kreditë u rritën me vetëm 1.1 përqind. Në anën tjetër, mbulueshmëria me provizione për humbjet nga kreditë shënoi rënie në 110.8 përqind nga 123.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak dhe nga 115.4 përqind në qershor të këtij viti. Kjo ulje pasqyron ritmin më të ngadaltë të rritjes së provizioneve në raport me zgjerimin e kredive jo-performuese.

**Grafik 38. Ndryshimi vjetor i vlerës së KJP-ve dhe Raporti i KJP-ve ndaj gjithsej kredive**




Burimi: BQK.

**Raporti i kredive jo-performuese vazhdon të jetë më i ulët për segmentin e ekonomive familjare krahasuar me atë të korporatave jofinanciare, ndërsa në të dy segmentet është shënuar rritje vjetore më e ngadalësuar e ekspozimeve jo-performuese, por rritje krahasuar me tremujorin paraprak** Më konkretisht, raporti i kredive jo-performuese për korporatat jofinanciare ishte 2.5 përqind, ndërsa për ekonomitë familjare 1.5 përqind. Ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje vjetore më të ngadalësuar të ekspozimeve jo-performuese, apo rritje prej 11.8 përqind nga 41.8 përqind një vit më parë, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak shënuan rritje prej 8.3 përqind. Korporatat jofinanciare ngadalësuan rritjen vjetore të ekspozimeve jo-performuese në 13.6 përqind nga 17.9 përqind një vit më parë, ndërsa krahasuar me tremujorin e kaluar shënuan rritje prej 1.5 përqind. Kontributin kryesor në rritjen e kredive jo-performuese në kuadër të KJP-ve e kishte sektori i tregtisë, i cili ka arritur në nivelin prej 2.2 përqind nga 1.5 përqind në vitin paraprak. Megjithatë, kjo rritje kryesisht u ndikua nga zhvillime të veçanta në një institucion dhe nuk paraqet dinamikë të përgjithshme të sektorit. Sektori i komunikimit ishte i dyti për nga kontributi në rritjen e kredive jo-performuese, duke arritur nivelin prej 3.1 përqind nga 1.2 përqind në vitin paraprak. Ndërsa, sektori i ndërtimitarisë dhe patundshmërive ka shënuar rënie më të lartë të kredive jo-performuese, apo rënie prej 16.4 përqind, pasuar nga bujqësia me 12.1 përqind. Rrjedhimisht, niveli i kredive jo-performuese në sektorin e ndërtimitarisë dhe patundshmërive zbriti për 0.8 pikë përqindje në 2.6 përqind, ndërsa në sektorin e bujqësisë zbriti për 1.2 pikë përqindje në 6.3 përqind.

**Pozicioni i kapitalit, i shprehur përmes normës së kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara me rrezik, arriti në 17.2 përqind nga 15.7 përqind në vitin paraprak.** Po ashtu, krahasuar me tremujorin e kaluar, ky tregues shënoi rritje për 0.7 pikë përqindje. Ky zhvillim reflekton rritjen më të lartë të kapitalit në raport me rritjen e mjeteve të peshuara me rrezik. Konkretisht, kapitali rregullativ i sektorit shënoi rritje vjetore prej 22.9 përqind nga 14.5 përqind një vit më parë, i mbështetur kryesisht nga rritja e fitimit të mbajtur, si dhe shtimit të kapitalit bazë nga disa banka. Brenda strukturës së kapitalit, 88.7 përqind përbëhet nga kapitali i klasit të parë, ku 66.3 përqind e tij përbëhet nga fitimi i mbajtur. Kurse, mjetet e peshuara me rrezik shënuan rritje prej 12.5 përqind nga 11.4 përqind një vit më parë (grafik 39).

**Grafik 39. Treguesi i solvencës**




Burimi: BQK.

**Treguesit e likuiditetit dhe financimit u përforcuan në TM3 2025, për dallim nga trendi rënës në pjesën e parë të vitit.** Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR) arriti në 235.6 përqind në shtator 2025, duke shënuar rritje për 24.2 pikë përqindje nga viti paraprak dhe 61.0 pikë përqindje nga tremujori i kaluar, çka indikon se bankat mbajnë mjaftueshëm mjete likuide për të plotësuar nevojat dalëse të parasë përgjatë 30 ditëve kalendarike të periudhës stresuese. Në fund të shtatorit 2025, teprica e likuiditetit ishte 18.3 përqind më e

lartë se një vit më parë, ndërsa rrjedha dalëse neto e likuiditetit ishte 6.2 përqind më e lartë për të njëjtën periudhë krahasuese. Po ashtu edhe treguesi i Financimit të Qëndrueshëm Neto (NSFR) shënoi rritje, duke arritur në 137.8 përqind nga 137.3 përqind në shtator 2024, apo rritje për 4.8 pikë përqindje nga qershori i këtij viti. Nivelet e treguesve të likuiditetit LCR dhe NSFR mbeten mbi nivelet e kerkuara rregullative të BQK-se prej 100%. Raporti i likuiditetit - i shprehur si raport i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtera – është rritur në nivelin prej 31.2 përqind nga 31.1 përqind një vit më parë, si dhe mbi nivelin prej 27.2 përqind në qershor të këtij viti. Kjo si rezultat i rritjes prej 21.1 përqind të gjithsej mjeteve likuide në raport me rritjen prej 5.4 përqind të detyrimeve afatshkurta nga tremujori i kaluar. Në anën tjetër, rritja më e shpejtë e kreditimit në raport me depozitat ka ndikuar që raporti kredi-depozitë të arrijë në 87.9 përqind nga 84.7 përqind një vit më parë (grafik 40). Megjithatë, në krahasim tremujor, ky raport ka shënuar rënie për 4.6 pikë përqindje, si rezultat i rritjes së përsheptuar të depozitave në raport me ngadalësimin në kreditim.

Grafik 40. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

#### 4.2. Sektori pensional


Sektori pensional shënoi zgjerim të mëtejshëm të asetëve, mbështetur si nga rritja e vlerës së kthimeve bruto nga investimet, ashtu edhe nga rritja e vlerës së kontributeve. Këto zhvillime pasqyrojnë stabilizimin gradual të kushteve financiare globale, pas një fillimviti të karakterizuar nga luhajtje dhe pasiguri në tregjet ndërkombëtare financiare që kishin ndikuar negativisht në kthimet nga investimet.

Në fund të shtatorit 2025, asetet e sektorit pensional arritën në 3.6 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 16.9 përqind (grafiku 41). Dinamika e zhvillimeve të sektorit mbetet kryesisht e përcaktuar nga FKPK, që përfaqëson 99.7 përqind të asetëve, dhe shënoi rritje vjetore prej 16.9 përqind nga 17.7 përqind në shtator 2024. Ndërkohë, FSKP shënoi ngadalësim më të theksuar të ritmit vjetor të rritjes në 7.2 përqind, nga 14.2 përqind në shtator 2024.

Portofoli i investimeve të dy fondeve pensionale mbetet i përqendruar në tregjet e jashtme. Megjithatë, ritmi i rritjes së këtyre investimeve ka shënuar ngadalësim krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Kjo dinamikë është ndikuar nga zhvillimet e fillimviti, kur luhajtjet dhe pasiguritë në tregjet financiare ndërkombëtare rritën kërkesën për pozicionim më të sigurt, duke orientuar një pjesë më të madhe të investimeve drejt tregut të brendshëm. Ky orientim u mbështet gjithashtu nga rritja e normave të interesit, si pasojë e rritjes së kërkesës së bankave për depozita.


FKPK investoi 80.2 përqind të portofolit në tregjet e jashtme, duke shënuar rritje vjetore prej 18.8 përqind, nga 23.1 përqind në TM3 2024. Nga këto investime, 99.9 përqind janë të orientuara në fonde të përbashkëta. Ndërkohë, investimet në tregun e brendshëm shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 10.0 përqind

Grafik 41. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK.

Grafik 42. Pjesëmarrja e investimeve të fondeve pensionale



Burimi: FKPK, FSKP.


krahasur me 1.2 përqind në TM3 2024. Brenda tregut vendor, letrat me vlerë vazhdojnë të dominojnë me 66.1 përqind të portofolit.

Nga ana tjetër, FSKP mbajti 78.7 përqind në tregun e jashtëm dhe 21.3 përqind të mjeteve në tregun e brendshëm. Investimet në tregun e brendshëm shënuan rritje të konsiderueshme prej 62.7 përqind krahasuar me 1.9 përqind në TM3 2024.

**FKPK shënoi rritje të vlerës së kthimit të akumuluar bruto në 212.5 milionë euro deri në shtator 2025, nga 202.6 milionë euro të realizuar në periudhën paraprake.** Kjo rritje u ndikua kryesisht nga performanca e TM3, gjatë së cilës u realizua rritja vjetore prej 77.0 përqind, më e larta krahasuar me tremujorët paraprakë.

Gjatë muajit prill 2025, tregjet financiare globale u karakterizuan nga rënie të theksuara, të ndërlidhura me tensione gjeopolitike dhe rritjen e tarifave tregtare në nivel global. Megjithatë, pas afro gjashtë muajsh nga kjo periudhë e paqëndrueshmërisë, të dhënat e raportuara më 30 shtator 2025 tregojnë se portofolët investues të FKPK-së kanë demonstruar rezistencë ndaj goditjeve të tregut, si dhe fleksibilitet gjatë fazës së rikuperimit të tregjeve financiare, duke kontribuar në përmirësimin e kthimit të përgjithshëm.

Grafik 43. Performanca e FKPK-së




Burimi: FKPK.

Si rezultat i këtyre zhvillimeve, çmimi i njësisë së aksioneve u rrit lehtësisht në 1.94 euro, nga 1.80 euro në fund të TM3 2024.

**nga ana tjetër, FSKP uli dukshëm vlerën e kthimit bruto në 485.3 mijë euro deri në shtator 2025, nga 899.5 mijë euro në periudhën paraprake.** Megjithatë, çmimi i aksioneve të FSKP-së shënoi rritje në 2.22 euro për njësi, nga 2.14 euro një vit më parë (grafiku 44).

Vlera e kontributeve të arkëtuara deri në fund të shtatorit 2025 arriti në 269.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore të konsiderueshme prej 18.6 përqind, nga 6.9 përqind të shënuar në periudhën paraprake. Numri total i kontribuuesve pensional deri më 30 shtator 2025 arriti në 905.2 mijë, duke shënuar rritje prej 4.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Grafik 44. Performanca e FSKP-së



Burimi: FSKP.


Rritja e vlerës së kontributeve është mbështetur kryesisht nga rritja e njësisë së koeficientit për shërbyesit publik, e cila u zbatua në dy faza gjatë vitit, ndërsa rritja e numrit të kontribuuesve pensional pati një ndikim më të kufizuar në këtë dinamikë.

Kontributet e FKPK-së, që përfaqësojnë 99.7 përqind të totalit të kontributeve, shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 18.6 përqind, nga 6.9 përqind një vit më parë (grafiku 43). Kontributet e arkëtuara nga FSKP-ja po ashtu shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 51.9 përqind në fund të shtatorit 2025, pas një rënie prej 0.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur në 745.3 mijë euro (grafiku 44).

### 4.3. Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve shënoi ngadalësim të ritmit të rritjes së asetëve dhe primeve të shkruara, veçanërisht në segmentin jo-jetë. Dëmet e paguara shënuan rritje, ndërsa fitimi neto vazhdoi të mbetet pozitiv, i mbështetur nga rritja e të hyrave dhe menaxhimi i kujdesshëm i shpenzimeve. Treguesit e qëndrueshmërisë dhe likuiditetit mbetën në nivele të kënaqshme, duke reflektuar një pozitë të qëndrueshme financiare.

Grafik 45. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK.

Në fund të shtatorit 2025, asetet e sektorit u rritën në 357.4 milion euro, duke shënuar ngadalësim të konsiderueshëm të ritmit vjetor të rritjes në 5.7

përqind, nga 12.6 përqind në shtator 2024 (Grafiku 45). Segmenti i sigurimeve jo-jetë përbënë 91.8 përqind të totalit të aseteve, ndërsa segmenti jetë mbulon 8.2 përqind të aseteve. Struktura e aseteve mbeti e orientuar kryesisht në instrumente me likuiditet të lartë, ku dominuan depozitat bankare dhe letrat me vlerë. Depozitat bankare shënuan rritje vjetore prej 10.1 përqind duke rritur pjesëmarrjen në total nga 46.8 përqind në 48.7 përqind. Ndërsa, letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, si kategoria e dytë më e rëndësishme në portofol, shënuan një kthesë në normën e rritjes, duke kaluar në tkurrje prej 4.7 përqind në shtator 2025 nga rritja prej 40.8 përqind në shtator 2024. Si rezultat, pjesëmarrja e tyre në asete u zvogëlua për 1.6 pikë përqindje në 14.3 përqind. Ngjashëm, asetet e risigurimit (rezervat teknike të risiguresve) shënuan rënie vjetore prej 4.7 përqind nga rritja prej 5.1 përqind në shtator 2024, duke zvogëluar pjesëmarrjen e tyre në totalin e aseteve në 14.4 përqind nga 16.0 përqind një vit më parë.

**Vlera e primeve të shkruara bruto shënoi ngadalësim të konsiderueshëm të ritmit vjetor të rritjes prej 5.6 përqind, nga rritja prej 15.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafiku 46). Ngjashëm, primet e shkruara bruto nga segmenti jo-jetë dhe jetë shënuan rritje vjetore të ngadalësuar, përkatësisht 5.6 dhe 4.9 përqind.** Në sigurimin “Jo-Jetë”, kategoria *Përgjegjësia motorike ndaj palës së tretë* (MTPL e brendshme) mbetet dominuese, duke rritur përfaqësimin në 56.5 përqind të totalit të primeve nga 55.3 përqind një vit më parë. Rritja vjetore e primeve në këtë kategori arriti në 8.7 përqind, duke reflektuar të njëjtin ritëm të rritjes si në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në sigurimin e jetës, kategoria dominuese “*Jeta e Debitorit*” shënoi rritje vjetore prej 6.8 përqind, nga rritja prej 21.4 përqind të shënuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Grafik 46. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Numri total i policave shënoi rënie vjetore prej 6.9 përqind, nga rritje prej 32.5 përqind në periudhën paraprake dhe zbriti në rreth 1.45 milion polica. Kjo dinamikë u ndikua kryesisht nga segmenti jo-jetë, ku numri i policave shënoi rënie vjetore prej 7.9 përqind, ndërsa numri i policave në segmentin jetë shënoi rritje vjetore prej 24.6 përqind. Megjithatë, primi mesatar shënoi rritje në 92.2 euro në shtator 2025 nga 81.3 euro në shtator 2024, si pasojë e peshës më të madhe të policave me prime më të larta në segmentin jetë, e cila kompensoi rënien e numrit të policave në segmentin jo-jetë.

**Dëmet e paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 20.7 përqind, krahasuar me 0.9 përqind të shënuar në vitin paraprak (grafiku 46).** Dëmet a paguara nga kompanitë e sigurimeve shënuan rritje vjetore të konsiderueshme prej 24.0 përqind, pas një rënie prej 1.3 përqind në periudhën paraprake, ndërsa dëmet e paguara nga Byroja Kosovare e Sigurimeve shënuan rënie vjetore prej 8.3 përqind, krahasuar me rritjen prej 24.6 përqind të shënuar në periudhën paraprake. Ndërkohë, dëmet e mbuluara nga risiguresit u dyfishuan në krahasim me një vit më parë.

Në kuadër të dëmeve të paguara në sigurimin e jo-jetës, kategoria ‘*Përgjegjësia motorike ndaj palëve të treta*’, me pjesëmarrje 54.4 përqind, shënoi rritje vjetore prej 10.1 përqind dhe arriti në 34.3 milionë euro. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga dëmet e lidhura me MTPL-në e brendshme dhe pastaj me policat kufitare. Ndërkohë, kategoria “*Sigurimi i sëmundjeve*”, që përbënte 21.2 përqind të totalit, shënoi rënie vjetore prej 0.19 përqind, duke arritur në 27.2 milionë euro.

Ndryshe nga rënia e numrit të policave, numri i dëmeve të paguara gjatë periudhës janar- shtator 2025 është rritur për 5.9 mijë dëme duke arritur në 171.9 mijë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nga ky numër, 171.3 mijë dëme janë paguar nga kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 613 nga kompanitë e sigurimit të Jetës. Ndërkohë, dëmi mesatar shënoi rritje prej 6.0 përqind gjatë periudhës janar-shtator 2025 krahasuar me periudhën paraprake. Ky zhvillim u ndikua nga shtimi i dëmeve me vlera më të larta, rritja e kostove të riparimeve dhe shërbimeve, si dhe nga presionet inflacioniste në treg.

**Fitimi neto i periudhës janar-shtator 2025 shënoi rritje vjetore të konsiderueshme prej 27.5 përqind nga 14.3 përqind një vit më parë, duke arritur në 13.3 milionë euro.** Të hyrat totale, të mbështetura kryesisht nga primet e shkruara, u rritën me 5.4 përqind dhe arritën në 112.9 milionë euro. Shpenzimet, të dominuara nga dëmet e paguara, u rritën me 3.0 përqind, duke arritur vlerën prej 99.6 milionë euro. Megjithëse rezultati financiar shënoi përmirësim, raporti i dëmeve ndaj primeve u rrit në 48.2 përqind në shtator 2025, nga 42.2 përqind një vit më parë, duke reflektuar ritëm më të shpejt të rritjes së dëmeve krahasuar me primet (grafiku 46). Megjithatë, raporti i kombinuar shënoi rënie të lehtë në 89.7 përqind në shtator 2025, krahasuar me 90.6 përqind në periudhën paraprake, pasi ulja e raportit të shpenzimeve – nga 33.3 përqind në 32.7 përqind – mbështeti përmirësimin e treguesit të përgjithshëm.

Kthimi mesatar në asete (KMA)<sup>4</sup> shënoi rënie në 6.1 përqind nga 7.5 përqind, ndikuar nga rritja më e shpejtë e aseteve mesatare (8.2 përqind) krahasuar me rënien e fitimit bruto vjetor (-12.6 përqind). Po ashtu, kthimi mesatar në kapital (KMK) shënoi rënie në 19.8 përqind, nga 26.5 përqind, pasi kapitali mesatar u rrit më shpejt (9.4 përqind) se fitimi neto vjetor (-18.1 përqind).

**Treguesit e qëndrueshmërisë financiare të sektorit të sigurimeve mbeten në nivele më të larta se kërkesat rregullatore, si në segmentin jo-jetë ashtu edhe në atë jetë.** Raporti i kapitalit ndaj marginës së solvencës u rrit lehtë tek sigurimet jo-jetë dhe mbeti i lartë tek sigurimet jetë. Raporti i kapitalit ndaj fondit garantues gjithashtu shënoi rritje të lehtë në të dy segmentet. Ndërkohë, treguesit e likuiditetit ruajnë pozitë solide, me raportin e mjeteve likuide ndaj provizioneve teknike dhe ndaj detyrimeve që shënoi rritje në segmentin e sigurimeve jo-jetë, por rënie të lehtë në sigurimet jetë. Mbulueshmëria me provizione teknike shënoi rritje të lehtë dhe vazhdon të mbetet solide me raport mbi njëqind përqind në të gjitha kategoritë, duke reflektuar se asete të mjaftueshme vazhdojnë të mbështesin rezervat teknike në të dy segmentet e tregut (tabela 1).

**Tabela 1. Treguesit e Qëndrueshmërisë**

Përshkrimi	Shtator 2025		Shtator 2024	
	Jo-jetë	Jetë	Jo-jetë	Jetë
Raporti i kapitalit ndaj marginës minimale të solvencës	145.99%	658.10%	144.40%	753.90%
Raporti i kapitalit ndaj fondit garantues	172.61%	178.30%	157.60%	164.90%
Raporti i mjeteve likuide ndaj provizioneve teknike	95.10%	147.38%	92.96%	150.03%
Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve	82.78%	141.92%	81.60%	143.43%
Mbulueshmëria me provizione teknike	112.00%	111.20%	110.30%	110.70%

Burimi: BQK.


#### 4.4. Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar

**Sektori mikrofinanciar dhe financiar jo-bankar vazhdoi rritjen dyshifrore të aseteve, por me ngadalësim të theksuar të ritmit të rritjes vjetore sikurse në tremujorin paraprak. Aktiviteti i kreditimit u zgjerua në të dy segmentet e sektorit, ndërsa aktiviteti i lizingut shënoi rënie, veçanërisht në segmentin e korporatave jofinanciare.**

Asetet e sektorit arritën në 700.7 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.6 përqind, ndonëse me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me rritjen prej 27.5 përqind në vitin paraprak. Struktura e aseteve mbetet e dominuar nga kreditë, pasuar nga lizingjet dhe mjetet likuide të mbajtura në bankat komerciale (grafiku 47).


Burimet e jashtme të financimit, që përbëjnë 91.1 përqind të totalit të financimit, shënuan ngadalësim të ritmit vjetor të rritjes në 16.4 përqind, nga 21.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Ndërsa, financimi nga burimet e brendshme shënoi rritje vjetore të konsiderueshme prej 107.1 përqind nga 63.8 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke reflektuar rritjen e rolit të tyre në strukturën e përgjithshme të financimit të sektorit.

**Grafik 47. Asetet e sektorit mikrofinanciar dhe IFJB-së**



Burimi: BQK.

**Grafik 48. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare**



Burimi: BQK.

<sup>4</sup> Për llogaritjen e treguesve KMA dhe KMK merret fitimi vjetor rotullues (TVM – Trailing Twelve Months), i cili përfshin të dhënat e 12 muajve të fundit nga periudha raportuese. Në përllogaritjen e KMK-së përfshihet fitimi neto, ndërsa në përllogaritjen e KMA-së konsiderohet fitimi bruto, konform Udhëzuesit metodologjik të FMN-së për Treguesit e Shëndetit Financiar (FSI 2019 Guide).


**Stoku i kredive të sektorit arriti në 525.6 milionë euro, duke vazhduar me trendin e lartë të rritjes prej 25.1 përqind nga 23.7 përqind një vit më parë.** Kreditimi për ekonomitë familjare shënoi rritje vjetore të përshpejtuar prej 23.6 përqind nga 18.2 përqind në shtator 2024, ndërsa kreditimi për korporatat jo-financiare ngadalësoi lehtësisht ritmin e rritjes në 27.3 përqind nga 32.8 përqind në shtator 2024 (grafiku 48). Sidoqoftë, rritja relative më e lartë e portofolit të kredive për korporatat jo-financiare, në raport me atë të ekonomive familjare, u reflektua në ndryshime të lehta në strukturë, me rënie të pjesëmarrjes së kredive për ekonomitë familjare në 58.9 përqind nga 59.6 përqind dhe rritje të pjesëmarrjes së kredive për korporatat jo-financiare në 41.1 përqind nga 40.4 përqind. Bazuar në aktivitetin ekonomik, të gjithë sektorët shënuan rritje, me sektorin e industrisë që shënoi ritmin më të lartë prej 36.1 përqind. Megjithatë, për shkak të peshës më të madhe që sektori i shërbimeve të tjera ka në portfolion e kredive të korporatave jo-financiare dhe duke marr parasysh rritjen e tij të lartë prej 28.4 përqind, ky sektor dha kontributin më të lartë në rritjen totale, duke arritur në 10.6 përqind.

**Lizingu ka ulur pjesëmarrjen në asetet e sektorit, duke zbritur në 10.5 përqind nga 12.9 përqind një vit më parë, i ndikuar nga rënia vjetore e aktivitetit të lizingut prej 3.2 përqind.** Ky zhvillim është reflektuar kryesisht në segmentin e korporatave jofinanciare, i cili mbetet dominues me 59.4 përqind të totalit të lizingut dhe shënoi rënie vjetore prej 5.8 përqind në shtator 2025. Ndërkohë, lizingu për ekonomitë familjare vazhdoi të rritet, por me ritëm më të ngadalësuar, duke arritur në 1.0 përqind krahasuar me 2.2 përqind një vit më parë (grafiku 49).

**Norma mesatare e interesit për kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar dhe financiar jobankar shënoi rënie të lehtë, duke zbritur për 0.4 pikë përqindje për ekonomitë familjare dhe me 0.1 pikë përqindje për korporatat jo-financiare (grafiku 50).** Ekonomitë familjare kanë norma më të larta interesi se KJF-të, me një dallim prej 5.7 pikë përqindje. Norma e interesit për kreditë konsumuese zbriti për 1.7 pikë përqindje në 22.3 përqind dhe norma e interesit për kreditë hipotekare zbriti për 3.8 pikë përqindje në 15.2 përqind. Në kuadër të kredive për korporatat jofinanciare, normat e interesit shënuan rritje të lehtë për sektorin e bujqësisë dhe industrisë, ndërsa kreditë për sektorin e shërbimeve zbritën lehtësisht dhe u karakterizuan me normën më të favorshme prej 17.4 përqind (grafiku 51).


**Fitimi neto i sektorit arriti në 17.1 milionë euro, duke shënuar ngadalësim të ritmit vjetor në 12.0 përqind, nga 19.1 përqind një vit më parë.** Ky zhvillim pasqyron ndikimin më të madh të rritjes së shpenzimeve krahasuar me të hyrat. Të hyrat e përgjithshme të sektorit vazhduan rritjen e lartë gjatë periudhës raportuese, prej 20.1 përqind, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak, duke reflektuar dinamikën e rënies së normave të interesit dhe ndër tjera edhe efektin e bazës më të lartë krahasuese.

Grafik 49. Vlera e lizingjeve të sektorit




Burimi: BQK.

Grafik 50. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar dhe IFJB-së



Burimi: BQK.

Grafik 51. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.


Rritja vazhdoi të mbështetet kryesisht nga të hyrat nga interesi, të cilat mbeten burimi dominues i të hyrave, duke reflektuar zgjerimin e aktivitetit kreditues. Edhe të hyrat nga jo-interesi kontribuan në rritje, megjithëse me një ritëm shumë më modest sesa vitin e kaluar. Shpenzimet e përgjithshme gjithashtu ngadalësuan ritmin e rritjes vjetore në 22.6 përqind nga 38.6 përqind, duke reflektuar stabilizimin gradual të kostove pas rritjes së theksuar në vitet e fundit të ndikuar nga inflacioni dhe kosto e lartë e financimit. Kontributin kryesor në këtë ngadalësim e dhanë shpenzimet nga interesi (30.5 përqind nga 76.0 përqind), të cilat vijuan rritjen, por me intensitet më të ulët. Ndërkohë, shpenzimet e jo-interesit shënuan rritje prej 18.4 përqind (nga 20.2 përqind) ndikuar kryesisht nga shpenzimet për personel dhe ato administrative (në 9.8 përqind nga 16.1 përqind).

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave u rrit në 78.5 përqind në shtator 2025, nga 76.9 përqind një vit më parë, duke reflektuar rritjen lehtësisht më të shpejtë të shpenzimeve në raport me të hyrat. Rrjedhimisht, indikatorët kryesorë të profitabilitetit shënuan rënie, ku kthimi mesatar në asete (KMA) zbriti në 3.5 përqind nga 4.1 përqind dhe kthimi mesatar në kapital (KMK) zbriti në 12.6 përqind nga 14.0 përqind.

**Raporti i kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive në sektorin e institucioneve mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare mbeti i njëjtë me tremujorin paraprak, por shënoi rënie të lehtë në 1.8 përqind nga 1.9 përqind në fund të shtatorit 2024, si rrjedhojë e rritjes më të shpejtë të stokut të përgjithshëm të kredive krahasuar me kreditë joperformuese.**


Mbulueshmëria e kredive me provizione vazhdoi të jetë e qëndrueshme, megjithëse zbriti lehtë në 138.7 përqind nga 139.8 përqind në periudhën paraprake (grafiku 53). Nga ana tjetër, raporti i kredive jo-performuese mbetet më i lartë për institucionet financiare jo-bankare (IFJB) krahasuar me institucionet mikrofinanciare (IMF). Për IMF-të, ky raport shënoi rënie vjetore në 1.6 përqind nga 1.7 përqind, dhe për IFJB-të shënoi rënie vjetore në 3.1 përqind nga 3.2 përqind në shtator 2024 (grafiku 54).

**Grafik 52. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar dhe IFJB-së**




Burimi: BQK.

**Grafik 53. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore**



Burimi: BQK.

**Grafik 54. Niveli i kredive joperformuese për IMF-të dhe IFJB-të.**




Burimi: BQK.

#### 4.5. Tregu i letrave me vlerë i Qeverisë së Republikës së Kosovës


Në tremujorin e tretë të vitit 2025, Qeveria e Republikës së Kosovës emetoi borxh të brendshëm në vlerë prej 55.0 milionë euro, duke rritur vlerën për 5.0 milion euro krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (grafiku 55). Megjithatë, raporti i borxhit të brendshëm ndaj Bruto Produktit Vendor (BPV) shënoi rënie të lehtë të 8.31 përqind nga 8.83 përqind në shtator 2024, ndikuar kryesisht nga amortizimi i borxhit të brendshëm.

Grafik 55. Shuma e ofruar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Grafik 56. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë sipas maturitetit për TM3 2025, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Pavarësisht se norma e kthimit në TM3 2025 ishte më e ulët krahasuar me TM3 2024, kërkesa për letrat me vlerë mbeti e lartë dhe tejkaloi ofertën. Megjithatë, qeveria emetoi vetëm përafërsisht gjysmën e shumës së kërkuar (grafiku 55).

Sipas investitorëve, fondet pensionale vazhdojnë të mbeten investitori kryesor në tregun e borxhit të brendshëm, me 41.0 përqind të stokut total, të ndjekura nga bankat komerciale me 25.0 përqind dhe institucionet publike me 24.0 përqind, ndërsa kompanitë e sigurimit përfaqësuan rreth 6.0 përqind të stokut të borxhit qeveritar.

Sipas maturitetit, emetimet e këtij tremujori u dominuan nga obligacionet dhjetëvjeçare, pasuar nga obligacionet pesëvjeçare (grafiku 56).

## Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 52, TM3 2025, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

### **Referencat:**

#### **BQK:**

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)
- c) Regjistri i Kredive: [Regjistri i Kredive - BQK \(bqk-kos.org\)](http://bqk-kos.org)

#### **ASK:**

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Indeksi i kostos së ndërtimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- f) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

#### **Të tjera:**

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë: <http://fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://ballina.fkpk.org)
- d) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Të dhënat nëntë mujore mbi borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/5dd2850a-be21-4e50-8860-9df088b1c540.pdf>
- e) Ministria e Financave Punës dhe Transfereve - Raport Nëntë mujor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës: <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/6d90a295-b45d-42c7-9982-242354d26b5a.pdf>

**Euribor:** Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

**ECB (BQE):** Economic Bulletin Research & Publications ([europa.eu](http://europa.eu)); Key ECB interest rates ([europa.eu](http://europa.eu))

**FAO:** [Home | Food and Agriculture Organization of the United Nations \(fao.org\)](http://fao.org)

**IMF (FMN):** [International Monetary Fund \(IMF\)](http://imf.org)

**World Economic Outlook:** [World Economic Outlook \(imf.org\)](http://imf.org)

**World Bank:** Commodity Markets: [Commodity Markets \(www.worldbank.org\)](http://www.worldbank.org)



Rr. Garibaldi, nr. 33, 10000 Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)